

B3A4  
N 35

SHKRIMTARË AMATORË  
DHE RAPSODË POPULLORË

# HAZIZ NDREU

Valët

e Drinit  
të Zi

891.983-1

HAZIZ NDREU  
N 35

15

# "VALËT E DRINIT TË ZI"

Poema dhe vjersha

LIOTEKA E SHTETIT  
GJURQIASTAL

~~39504~~  
13811

poemat, fësi, vjersha  
monologji, rima, verset, mahnitë  
çordët, alfabeti, rastësia  
etj. kaba njëjjetë vërtetë

20-2000 vjetësh 2000-2000 vjetësh 2000-2000 vjetësh

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## PARATHANIE

Rapsodi ynë, Aziz Ndreu po paraqitet para lexuesve me librin e tij të dytë. Vepra përmban një poemë epike dhe disa vjersha. Autori i këndon trimnisë dhe guximit të malësorëve të Dibrës, që luttuen për të mprojtë tokën e tyne kundër ushtrisë aneksioniste të krajjit të Serbisë. I këndon me hov Partisë sonë, rinisë, Dibrës, Armës së Sigurimit dhe Ushtrisë sonë Populllore.

Poema «Valët e Drinit të Zi» trajton një betejë që bahet në mes të shqipëtarëve dhe ushtrive serbiane në tokat tona. Në Luftën Ballkanike ushtritë serbe e malazeze kundër Turqisë, sulmojnë Shqipninë e veriut, Shkodrën e Dibrën, me qëllim që të rrëmbejnë pjesë të mira t'atdheut tonë. Ata nuk i përfillin fare dëshirat dhe perpjekjet e popullit shqiptar për liri. Ata nuk e njihnin fare indipendençen, që u çpall në nandor 1912. Ata nuk e njihnin fare Shqipninë.

Kryengritja e Kosovës, luftat kundër Turgut Pashës, Xhavit Pashës, kryengritja e Dedë Gjollit kundër Turkut, çetat dhe luftat e tyne në jugë u kunorëzuan me çpalljen e pavarësisë në Vlonë. Mbe turinat e ushtrisë turke në disa vende si në Shkodër nuk përfaqësonin ma Turqinë tek ne. Ditët e këtyne mbeturinave ishin të numrueme, po të mos

ndodhnin komplikacionet që solli lufta ballkanike. Pra serbët e malazezët vinin tek ne jo si çlirues, por si aneksues, si shtypës, siç e treguen me vepra.

Kongresi i Bazelit (Svicër) në nëndor 1912, ku mori pjesë edhe Lenini me bolshevikët rusë, i dënoi plotsisht sulmet e shovenistëve fqij me Shqipërinë dhe kërkoi të luftohej kundër shtypjes së popullit shqiptar. (Shih: Historia e Shqipërisë, II, Tiranë 1965, fq. 352).

Populli ynë, kur ka qenë puna për të luftue kundër turkut, ka luftue edhe krah për krah me serbë e malazes. Shembuj ka mjaft gjatë historisë s'okupacionit turk në Ballkan.

Por tashti, që shqipëtarët ishin zgjue dhe kishin krijue të parin shtet mbas vdekjes së Skënderbeut, ata nuk e duronin kurrsesi zgjedhën serbe dhe luftonin kundër këtyne ushtrive grabitqare.

Një rast të tillë përshkruen poema e rapsodit Hazis Ndreu. Dihet se serbomëdhejtë blenë me parë disa krenë, në mënyrë që të hyjnë pa telashe themellë në tokën tonë nga ana e Dibrës. Lufta që banë malësorët tonë ishte popullore, kundër serbomëdhejve dhe kundër krenëve tradhëtarë. Shqipëtarët e maleve të Dibrës: Reçi, Dardha, Luma dhe krahi na të tjera, kur shikojnë se po shkelen vendet e tyne nga një ushtri serbomadhe prej dymbëdhjetëmijë vetësh, me gjithëse t'uritun, pa armë, pa veshje, sulen mbas kushtrimit, mblidhen mbas prisave të tynë, të cilët janë edhe ata njerëz të thjeshtë dhe luftëtarë të fortë. Njëmij malësorë e shpartallojnë ushtrinë serbe të paisun me armë moderne.

Autori i pershkruen bukur betejat, kacafytjet dhe trimnitë e shqipëtarëve. Dufin autorit e shpreh sidomos kundër krajlit dhe njerzëve të tij, që bahan

*shkak luftash të padrejta dhe marrin në qafë ush-trinë, bijt e popullit serb.*

*Si rapsod Hazis Ndreu asht për t'u urue për kë-to vjersha. Në to spikat talenti. Ai i çfrytzon me mjeshtri figurat popullore, shprehjet, fjalët dhe frazeologjinë e popullit. Ai ka krijue një varg pak a shumë të vetin, të cilin përgjithësisht e përdor mirë. Hazizi asht epik. Luftimet i përshkruen të gjalla dhe të ndryshme simbas rastit. Përpinqet mos të përsërisë, siç ndodh zakonisht në rapsodët e tjerrë. Veti tjetër e Hazizit asht se i rri besnik gjuhës dhe shpirtit popullor. Edhe kur shkruen vjersha me temë të sotme, ai i vesh ato me fjalë e shprehje popullore dhe nuk fut pa nevojë fjalë moderne të hu-eja dhe shprehje gazetareske, siç ndodh dendun tek disa rapsodë të tjerrë. Ai shkruen vjersha popullore me frymzim e jo artikuj të vumë në varg. Në këtë drejtim Hazis Ndreu shërben si shembull për ata që bajnë përpjekje të krijojnë poezinë e tyre origjinale simbas vargut tonë popullor. Veç kësaj Hazizisi gjen rima të bukura, të cilat e ndihmojnë fry-mëzimin. Rallë gjen tek ai rima me «i» «i» e «u» «u», ose rima follore pa nevojë. Në vjershat «Në sulm mbi barrikata», «Shpatë e çveshme e klasës punëtore», «Dibrës sime», «Falë iu qofshim në shekuj të jetës», «Arma e re», gjejmë të kjartë dashuninë e autorit për Partinë dhe për rrugën e lavdishëme që ka ndjekë e ndjek populli ynë nën udhëheqjen e saj. Edhe në këto vjersha hasim vargje të tëra me të vertetë poetike si në poemë, që t'emocionojnë dhe të mbushin me krenari.*

*Por edhe Azizi si rapsod nuk u shpëton nganjëherë përsëritjeve dhe vargjeve të dobët. Këtë auto-ri duhet ta ketë para sysh në t'ardhmen dhe, me një punë ma kambëngulse, të na japë përherë vepra të mira, të cilat masa i pret me dëshirë.*

*Urojme që vepra në fjalë të jetë një nxitje për një punë ma të ngritun dhe ma të bukur në t'ardhmen. Populli ynë i lexon me déshirë rapsodët kur ata i këndojnë bukur Partisë, punës së madhe që kryhet sot në vendin tonë, dhe traditës sonë të lavdishme, luftës sonë për liri.*

K.J

*Laç, shtator 1966*

„*Urojme që vepra në fjalë të jetë një nxitje për një punë ma të ngritun dhe ma të bukur në t'ardhmen. Populli ynë i lexon me déshirë rapsodët kur ata i këndojnë bukur Partisë, punës së madhe që kryhet sot në vendin tonë, dhe traditës sonë të lavdishme, luftës sonë për liri.*

**VALET E DRINIT TE ZI**

(Poemë)

I

Drini i Zi ecën me shkulma valë-valë,  
tue u përplasun nëpër kepa ball' për ballë,  
her' në shtrat e her' prej shtratit ai tue dalë;  
len në t'majtë të dy malet Reç e Dardhë,  
që i mbështesin brinjët në rrasë të gjallë,  
ngul' shtëpijat kodër m'kodër rrallë e rrallë,  
fukara, po, të këputun mot mbas moti,  
gurë e dhë ku duken zi prej tym baroti  
kundër turkut, kundër serbit, pa bajraqe; <sup>1)</sup>  
cullt' <sup>2)</sup> pa bukë e vet' tue vdek' me pushk' përf  
faqe!

Në nandqindedymbëdhjeten, në dhjetor,  
mbuloi dimni fushë e male, shi e borë.

Uke Shkambi rri mbështet' në der' t'kacolles,  
me nji pece nji pastrim i ban kapsolles.

Kanjihéře i lshor sytë në koshar:

nji jav' bukë, s'ka ma tepér në hambar.

Rrin i tretun ndër mendime tue mendue:

«Asht ma mirë tē mos kesh as cull», as grue!

1) Pa bajraqe = pa bajraktarë.

2) Cullët = fëmija.

Si mund t'ruhet grueja e fmija, burrë i dheut,  
kur t'len buka edhe krypa n'dit' të shndreut?  
Si mund t'ruhen edhe t'rritten fmijt' e mjerë  
në nji odë që nuk ka as xham as derë!  
Un' çuditem se si rrojmë e s'kemi vdekun,  
natë e ditë shpin' pér zjarmi, zbathë e vdeshun!»  
«Pse mendohe, Uke Shkambi? — po i thot'  
grueja —

Nuk asht than' veç unë e ti me vdek' nga uja! 1)  
Tre çerekët si ne i ke në Dardhë e n'Reç,  
Ku asnjeni s'asht ma mir' veç n'qoft' ma keq!»

Në mëngjes, kur zbardhi drita, bumblooi lodra,  
ushtoi zani, krisi pushka nëpër kodra:

«Hej ju burra, t'Reç e Dardhës, bij t'malsisë,  
krali i serbit me fuqi po i msyn Shqipnisë,  
s'do me ditun se flamurin ngritëm n'Vlonë,  
e se turkun hoqëm qafet përgjithmonë!  
Vendet tona dashka serbe me na i bamë,  
sepse gjyshat trashigim ja paskan lanë!  
Ka ra Shkodrës, bregut t'Bun's e n'Tarabosh,  
ka ra Lumës dhe malsisë qosh e m'qosh!  
ka ba be, qeni i qafirit, n'fenë e vet:  
ja nën mue, ja t'gjith njiher' kam pér t'ju shkretë!»

Më t'dy malet shkoi kushtrimi si rrufe,  
vend pér vend tue u përhapun nëpër dhé, 2)  
tue arritun deri n'vesh të mullixhiut,  
n'maje t'malit der ke tufa i shkoi bariut.  
Ky kushtrimi i përshkojti vrimë e skutë,  
n't'tana skajet kund nuk mbeti pér pa u futë.

T'u lshuen burrat përmbas zanit të kushtrimit,  
t'gjith nji hovi, si shpejtsia e valve t'Drinit.

---

1) Uja = urija.

2) Dhé = këtu: popull.

Teposht' Sukës, sa mund, farran' 1) ky Fal Kasami,

nëpër Ceka, 2) sa mund, merr 3) Halil Selmani,  
nëpër lisa tue vet-tue Dali Lami,  
n'krahanuer tue iu tundun xhamadani.  
Xhafer Doda, burr' zeshkan, mustegezi,  
vesnë e mbathun si me qen' dhandër i ri,  
kur vikat' zani i tij po mirrte gjamë,  
tue shpue Reçin nëpër gryka anembanë.  
Hasan Rama del prej kulle shum me vrullë,  
tue lan' shtëpinë fillikat më gra e m'cullë,  
përvjel' krahat, m'krahanuer kmisha zbërthyë,  
kryqzue rrÿpat me fyshekë e lshue përkije, 4)  
meje m'meje 5) gur më gur e lshonte hapin,  
kambës s'tij nuk ka ortak t'ja mbrrije vrapin.  
Nëpër gjerdhe Halim Lika e Xhafer Sula,  
me të madhe tue bërtitun «M'tani, 6) burra!»  
Kndon manzeri i Suf Xhelilit n'Listivalle, 7)  
peshë tue çuemun gjith krahinën mal e zalle.

E si rreshmja kur rrëshqet në male t'brenit,  
tue u ngjeshun e tue u rritun rend mbas rendit,  
qekso soji rendin burrat mbas kuvendit.

Suf Xhelili zanin çoi në mes t'kuvendit:  
«Beja rren», se vet' do t'shkretet qeni i qenit! 8)  
Se kët vend nuk mund e shkreti otomani,

1) Rran = vrapon.

2) Ceka = emen vendi guriqhte në rrësh të Drinit.

3) Merr = këtu vrapon fort.

4) përkije = sipër.

5) meje m'meje = megje m'megje, kufi m'kuçi.

6) Mtani = mbi ta!

7) Listivalle = emën vendi.

8) Idea e krejt frazës: ma sa baj be rrenë, aqë jam  
i bindun se do të shkretohet qeni i qenit.

as orditë me pashallarë, as mbret sulltani!  
Paska dalun fillikat në kmishë e n'brekë,  
malli e marrka ktu n'rreth t'Drinit për me dekë!  
Se Shqipnia asht mësuem me këto vala,  
n'shkulma t'tyne qenë gjithmonë dhe Reç e Dardha!  
Reç e Dardha janë të njohtun në Shqipëni  
si dy male t'pakoritun në trimni!  
Më çdo skaj ku ka rrënkuue toka shqiptare,  
hutat tonë n'her' të par' kanë ra batare!  
Reç e Dardha jo shum larg, por njitash vonë,  
si zakon po, që ka qenë ndër ne gjithmonë,  
rrrokën hutat gjith sa qenë burra për shpi  
edhe shkuuen drejt në Plavë edhe n'Gusi,  
me i ndihmues kundër shkjeve t'Malit t'Zi;  
e së bashku me gjith Gashë edhe Krasniq,  
Hot e Grud', Nikaj - Mertur e me Nikshiç,  
në Sutjeskë mun ke ura ban' kërdi:  
Shkodr' e male nuk ja lshuen Malit të Zi!  
Ne si babat do t'luftojm me nji kapsolle,  
dersa t'shkreten robt e shpis' me gjith kacolle!»  
e n'shkretinë t'vij' kët vend ta mbjell' kërtolle!» 1)

Për drejt Lumës u drejtue dora e Ukut,  
shllunga-shllunga tue i dal' tymi prej çibukut:  
«Hajdi, burra, Reç e Dardhë si e kem zakonin,  
ujë e mizë 2) t'ja zamë serbit Kolasianin!  
T'ja zam' pritat n'ata kepa n'Gur të Zi,  
t'mos kaloje asnji kambë, jo dymbdhjet' mij'!  
Kush t'mbes' gjallë, t'dale mendsh e t'bjere n'Dri,  
t'i shkojë britma si çakallit n'kupë të qiellit,  
t'mos e njohë drit'n e han's as drit'n e diellit!»

1) Kërtolle = patate

2) ujë e mizë = me shumicë si uji e miza.

«Mirë ke folun, të lumtë goja, Uke Shkambi! —  
i tha Ukës n'at kuvend Halil Selmani. —  
Krale Petri na njieh mirë gjysh e babsivsh,  
se edhe dosen ja kem vra me gjith këlysh,  
ja kem mbajtë e do t'ja mbajmë pushkën ndër  
besa bes' s'do t'i lëshojmë asnji pllambë!  
M'falni, burra, se e zgjatuem shum kuvendin,  
se n'kso ditësh muhabeti s'e ka rendin,  
por dersa ne t'kemi pris Elez Isufin,  
Reç e Dardhës s'gjindet kral t'ja presë dufin!  
Çohi t'nismi pa iu ngjitun serbi Krumës,  
se n'Ujmisht ne na përgjojnë malsor't e Lumës,  
fill tue zanun n'qosh t'bajrakve në Poslisht,  
m'Urë t'Vezirit, m'uji t'Mallës e m'Ujmisht,  
qysh nga fshati Topojan e në Bushtricë,  
n'uj' te Lapa, në Kalizë e n'Veleshicë!»

Reç e Dardh' me malsi t'Lumës jan' bashkue,  
bajn' kuvend e lidhin besë si me qëndrue.  
N'tef të mej's Elez Isufi n'kambë u çue:

«A po i ndieni njady llafe, o lumnjanë!  
Nji besë burrash, heret, Lum's ja kem pas' dhanë:  
juve vetëm n'dit të kubit mos me ju lanë!  
Besës s'dhanun ne besnikë i kem' qëndrue,  
për krah jush ne kemi ardhun me luftue!  
Kundër kralit ose kemi me fitue,  
ose dekun krejt në Lumë e të farue:  
N'Reç e n'Dardhë marre kurr nuk kemi çue!  
Se shqiptari që s'di t'vdesë për komshi,  
ju ap besen, ai nuk vdesë as për rob t'tij!»

Ramadan Zaskoci dhe Islam Spahia,  
të njohtun për prisa nga e tan' Malsia,  
t'urt' gjithmonë e t'ambël për hak t'vegjelisë,

t'idht' pér mbret edhe pér kralat e Serbisë, u përgjigjen t'dy njiheresh pér nji za, me t'than' mendja se me fjalë e kishin ba:

«Elez-a, ti qofsh gjithmonë faqebardhë me gjith popull të malsive Reç e Dardhë!»

Pastaj Danit<sup>1)</sup> menjiher' ftyra iu kendell, <sup>2)</sup> n'midis t'ballit drejt përpjetë iu çue nji dell:

«Ju malsor' t'bajrakve t'Lumës, ju drejtohem, në flamurin kuqezi po ju betohem, po s'ua bamë ushtarve t'kralit si t'Xhavitit,<sup>3)</sup> që i ndezëm me fitil të dinamitit, tue i ndemun grumbuj-grumbuj n'dushke t'ahut, haram paçim gjiun e nan's e buk'n e kaut!»

Të tan' burrat, gjashtqind pushk' sa qen' në kambë, u përgjigjen: «Jemi Luma që kem kanë! Tan' në zarm me gjith fëmi kemi me dekë, kambën mbrapa kurr nuk kemi pér ta t'hekë!»

«Hajdni, burra, pra! — iu thirri baba Lami<sup>4)</sup> filloj terri, sa ka zanë me ra akshami! N'tana çukat zini vend ke istikami, n'kodër t'Gjomcit, n'an'n e kndejme t'majes s'Pjeshës, Gryk'n e Shkallës der te kepi i Beleshës; kudo t'jini qepniu tokës, mbështetniu mejës, t'dymbdhjet mijët ta kalojnë lumin e Shejës:

1) Dani = shkurëm i emnit Ramadan.

2) iu kendell = iu çel.

3) Xhaviti = Xhavit Pasha

4) Baba Lami = Islam Spahia (thirrej baba Lami nga populli).

t'u shkojë mendja për tamam zabitve t'kralit  
se n'kto male veç kan' mbetun zogjt' e malit!  
Lini t'hecin sa t'u hullën<sup>1)</sup> n'gryk' t'martinës,  
atëhere ma sa të mundni qaf's e shpinës!  
Kur të hyjn' mbrenda rrëthimit për rrëpine,  
Kamber Musa ka me u ramun mbrapa shpine!»

## 2

Maja e Rrunës vrantue ishte për gjith anë  
dhe Gjallica kishte varun kryet ndër kambë,  
kur i shifshin retë e murme shlluga-shlluga  
rrafshës s'Lumës nëpër qarra ë nëpër buga.<sup>2)</sup>  
Mbush' bugaja plot për plot në dushk e vgjerre,<sup>3)</sup>  
divisionet nji mbas nji me kuaj e qerre:  
tundej mali, çuhej toka vija-vija,  
mori njerzish, si t'qe shembun tan' Serbia,  
katrrosh<sup>4)</sup> trupat me kollana e granata,  
vjerrë për krahësh pushkë të shkurta e të gjata,  
gryka topash, gjylet varg kunorë kunorë,  
hapin shtrimun, mitrolozat për nën dorë,  
ngarkue mushkat me pagure e kaseta:  
shum sherbes si me shitetë n'çifliqe t'veta.

N'fund t'kolonës, nja dhjet' hapa nga të tjerët,  
Vlladovici me Millanin qajshin dert:  
«More Vllado, ç'e duem luftën me Shqipni,  
a pak tokë kemi neve në Serbi?  
A pse i dashka kokrra e qejfit gospod kralit,

1) hullen = afrohen

2) buga = pyell buge e qarri = lloj druni lisi.

3) vgjerra = djeir, tokë e papunueme.

4) katrrosh = sërmatosë randë.

në Shqipni t'vijë e t'jese pika e djalit?  
Kta shqiptarët kan' të drejtë të na shkepin,  
të na zanë e pér së gjallit të na rjepin!»  
«Po, mor Millo, pér kto llafe ke të drejtë,  
se kjo e mirë, besa, shpejt ka me na gjetë!  
Veçse kralin shtifte rrufeja e e coptoitë,  
n'derë të tijen sa ma par' pula këndoftë!»  
«Brzhi,-brzhi! <sup>1)</sup>» u ndëgjue nji za i thellë,  
za i çjerrun si ndoj derr kur vrret në shpellë.

Ishte zani i kumandarit Mark Dushanit, <sup>2)</sup>  
që pér mesit kishte ngjeshun klliç taganj,  
dy koburet çatallue më dy anë,  
mjekrra e zezë n'krahanuer tri pëllambë,  
shpatullgjanë si me pa nji anë malit.  
n'dhe të tokës sa s'i piqte barku kalit,  
n'anë të majtë i shkëlqejnë dy kryqa arit,  
dhanë nga krali pér merita kumandarit.

N'krye të fushës shtërngoi kalin n'pik' të vrapi,  
porushniku <sup>3)</sup> po e ndiqte hap mbas hapit.  
M'qosh t'katundit, ende n'Nagë s'kishin hi,  
n'kodër t'Lamës u takue më nji bari:  
«Zdravo <sup>4)</sup> ti, more bariu katundar!...»  
«Mo' m'thuej «zdravo!», bre katil, se jam shqiptar!»  
«Ktij shqiptarit jepja gjys'n e metelikut!»  
i dha urdhën menjihërë porushnikut.

Mbas pak hapash hyni n'Nagë,  
syt' përjashta si bërthagë.

- 
- 1) Brzhi, brzhi = shpejt, shpejt! <sup>(sllav.)</sup>  
2) Mark Dushani = komandanti serb. <sup>vq = agus</sup> <sup>(s)</sup>  
3) Porushnik <sup>ë</sup> = Toger, oficer ordinanc. <sup>ë</sup> <sup>(s)</sup>  
4) Zdravo = përhëndetje, tungjatjeta! <sup>ë</sup> <sup>(s)</sup>

U takue me nji burr' t'vjetër  
se n'katund nuk kishte tjetër:

«**Zdravo** tine, more mik!»

«**Zdravo, gospodin vojnik!**»<sup>1)</sup>

«Din nji fjal' mue me ma thanë:  
a kam prita n'Kolasian?»

«Ajo gajle hiç t'mos zanë,  
asnji prit' s'e ke n'kto anë,  
qysh këtu e në Tiranë,  
s'ka me t'hymun ferr' në kambë!

Përbas Markut shkojn' ushtria renda-renda,  
dikush rrugës, dikush hy në shpia mbrenda.

Në t'papritun nji ushtar prej rreshtit doli:  
ai me emën po na thirrej Ramë Sokoli.

Pa iu hudhun i tha plakut: «Tungjatjeta!»  
«Kush je ti që po flet shqip, bre t'u shoft' jeta?»

«Kosovar jam prej krahin's Llap e Gallap,  
na mblodh serbi e na vu përpara n'vrap!

Nuk jam vetëm por me mue mbushen dyzet,  
mshelëm dyerët edhe i lam' konaqet shkret:

të dyzetët kem vendue me u ba batare,  
tybe n'Zotin me e trahctue tokën shqiptare!»

Kosovarët si dhanë fjalë ashtu qëndruen,  
edhe vehten edhe fisin e nderuen,

se në grumbuj të serbianve thellë u strukën:  
arm't e tyne nëpër prita hiç s'u dukën.

Në t'papritun, n'ndoij errsinë kur kërsasin,  
oficera o truca<sup>2)</sup> serbësh n'tokë i rrasin.

1) gospodin vojnik = zoti ushtar.

2) truca = tufa, grumbuj.

Zbardhi drita, dit' pa diell po burg i zi,  
retë pérplasen n'njena tjetrën me stuhi,  
kokrra breshni ngjeshë me akull bien me shi.  
Burrat rrinë pushk' pér syu n'istikame.  
zbathë e vdeshë, pa jakuc', pa koperane,<sup>1)</sup>  
u shkon ujt konop-konop tue u varë pér qafë,  
dhet' fyshekë s'kanë ma tepër në sylaf,<sup>2)</sup>  
të harmue me boshlleqe e sllojn brezin;<sup>3)</sup>  
dhe prej tyne gjysma ndez e gjysma s'ndezin.  
Lera<sup>4)</sup> gurësh grumbullue kan' në lëndinë,  
katër burra do t'luftojnë me nji martinë,  
dikush tietër në nji qoshe mpref sakicën  
të pres' hasmin, t'marr' fyshekët dhe peticen.  
Kan zan' Qaf'n e Kolasianit der n'Gjabrricë.  
Re ushtria termal shpatit na janë nisë.  
Me sa njefen n'dushk të shpeshët lis e shkoza,  
aq mund t'njefish vetëm topa e mitroloza.  
Renda-renda sa t'shef syni saça t'zes  
mbuloi kodra, gardh e skuta at mëngjes.

Krisi pushka e mitrolozi, ushtoi Zepi,<sup>5)</sup>  
u dogj dheu pér nën kambë edhe u ndez kepi.  
Thekun plumbash prej Beleshi<sup>6)</sup> n'Hie t'Pjeshkës<sup>7)</sup>  
bien gjethet si me fry murranı bjeshkës,  
kur po shkunden në të dalun muejt e vjeshtës.

1) jakuc, koperane = llojë veshjesh të burrave n'ato anë.

2) sylaf = vendi ku luftari i kohës mbante fishekët.

3) e tërë fraza: ngjeshin bres të leckosun e me boshllëqe.

4) lera = grumbuj.

5) Zepi = emën malit.

6) Beleshi = mal.

7) Pjeshka = mal.

Dymbdhetë topa n'Bokë t'Bushatit<sup>1)</sup> kur kërsasin,  
dymbdhet' gjylet n'kodër t'qafës po pëlsasin,  
zveshin tokën e në dritë e qesin rrassen.  
Më të djathtë, më të majtë drejt Kopshtnisë<sup>2)</sup>  
dhet' boria bien njiherësh n'mes t'ushtrisë,  
që të dheta jepin urdhnin e sulmimit,  
me të dridhun si në mes të Erbeinit,<sup>3)</sup>  
regjimentet tan' njiherit bajnë: «urra!»  
ul'rojn' grykat dushk e shkoza tue përla.

Sa po vinte e po shtohej britma e çjerrë,  
britm' e keqe, zorr't e barkut me t'i nxjerrë,  
njiqind shpirtën me i pasun, n'at sahat,  
s'ta merr mendja se të mbetet nji në shtat.

Mjekérziu jep komandën n'qoshe t'Bica:  
«Më të djathtë t'zihet kodra ke Gjabrrica,  
shpejt të bahan pozicionet për nën shkoza  
dhe t'vendosen katër topa e mitrozo!»  
Mbrenda orës urdhni i mjekrës u zbatue,  
vullnetarët an'n e djathtë e kan lirue.

N'tthyeme t'ditës, tre sahat pa ardhë akshami,  
bash kur mjekrën po paltonte Mark Dushani  
me sulm t'fundit t'shkul' shqiptar't prej istikami,  
Elez Isufi një dytopa n'qaf' i qiti  
për drejt kodrës bukur mirë i tereziti.  
Këta topa ja kish mbajt' mbretit t'Turqisë  
tre muej para, kur theu qafën prej Shqipnisë.  
Me t'dy topat kishte vetëm pesdhet' gjyle,  
disa s'digjshin se i kish lan' mbreti me hile.

1) Gryka e Bushatit = emën vendi.

2) Kopshtnia = vend.

3) Erbeini = periudha ma e ftohë e dimnit.

Dy topçit' tē katér topat i çfarosën,  
dy nga dy mbrenda minutit i vulosën.  
Uke Shkambi iu vikati prej përfund:  
«Hallall buka dhe ai djep që u ka përkundë:  
krali i serbit n'qaf' na ra, koci iu humtë!»

Elez Isufi n'mes t'malsorve po bërtet;  
zani i tij, po, edhe tok's i jep gajret:

«Sillni, voca,<sup>1)</sup> pa mëshirë ktij beterri,  
hala mirë pa e mbuluemun vendin terri!  
Rrokullisni bregut t'Drinit, në kta shkrepa,  
lshoniu n'shpinë sa tē mundni gurë e kepa,  
asnji gjallë në kto vise mos e lini  
mbytni n'uјë, sikur klladat<sup>2)</sup> t'i marr' Drini!»

Jehoi zani, maje n'maje mori Rrunë,  
në t'gjithë anët istikamet u trazuen.  
Prej Beleshe në Gjabrricë flakë u ndez;  
tē tan' burrat krejt njiherë: «A besë a besë!»  
Reç e Dardha përmbi serbin bajn' yrysh,  
kurrnjiherë s'u vret tepër, por në mish.  
Sa her' pushkët n'kacafytje kur kërsasin,  
rreshtna kokash nëpër kepat i përplasin.  
T'bijt e kralit sa mund t'hikin tē tatpjetës  
si në zgjue kur i vihet tymi bletës.

Dan Zaskoci kodrës s'Bicaj shkon në kambë,  
pushkën n'dorë, xixa t'kuqe qet me dhambë:

«Biniu, burra, sikur turqve në këshllà,<sup>3)</sup>

1) Voca = djem.

2) Kllada = mbeturina.

3) Këshlla = kazermë.

faqebardhë pér shqiptar' nji dit' me u vra,  
sa i gjallë n'kokërr t'shpinës me krye çà,  
t'na shkoj'jeta brez mbas brezit fukara,  
t'rrim' tue lypun copa buke nëpér shka!»

Stojoniçi vrik i zgjodhi njizet vetë,  
Nexhip Visten kish hetue vetë i tretë,  
që në heshtje tue përgjue rrin' nën kep.  
Stojoniçi kishte le n'thellsı t'Serbisë,  
djalë i pashëm porsi rremi i selvisë,  
trim të gjallë e kishte le e ritun nana,  
n'xhep të setrës i dallojshin dy nishana,  
pasha besën, hiç s'i bante leqe kamba.  
Edhe t'tjerët qen' t'sprovuem pér gisht të shllinës,<sup>1)</sup>  
kamba-kambës i shkojn' Stojoz mbrapa shpinës.

«Lini, trima, sa t'aviten këto bisha —  
u tha shokve n'streh' të kepit Nexhip Visha. —  
T'ua përpjekim të tri grykat n'krahanuer  
e t'i ndezim sikur eshkën me unuer.  
T'ua përplasim t'gjith njiherë pushkë e britëm,  
t'u dal' shpirti hala plumbin pa ua ngjitun!»

Tri martinat kur u shkrepën pér nji thumbi,  
gjashtë u rrzuënë, hangri mish sa deshti plumbi!  
«Biri i shkinës, ndale kamben! ma kadalë!  
Jam shqiptar e pushk' pér pushk' mos t'qofsha falë!»

Stojoniçi po shkërpudhet më nji vend,  
po çon shokët nji nga nji të gjith me rend.  
Shok't e Stojoz, sa her' n'kambë kur po çohen,  
n'krande t'shkozës nji mbi tjetrin po paltohen.  
Stojoniçi prej kapote bombat qiti,  
ja lshoi strehës, mu në kepin ke Nexhipi,

1) gisht të shllinës = gisshit heqës të këmbzës së pushkës.

ja la shokët pa pik' fryme, n'vend ja mbyti  
dhe Nexhipin n'krahanuer e goditi.  
Stojoniçi vetë i pesti s'luen në pritë,  
pa vonesë i lshoi kepit bomb'n e dytë.  
Nganjiherë ç'ban dekiku s'ban sahati,  
Nexhip Visha pa pëlsit' bombën e kapi,  
ja lshoi Stojos drejt kaptinës pa vonesë.  
Pushkë e hollë me nji t'shtim' vrau pesë,  
copa-copa me u mbledh' kocat me thes.  
Bomba e parë fort Nexhipin e troshiti,  
por pa Stojon nuk pranoi me i dalun shpirti.

Xhafer Doda kah Rrapnica me gjith Reç,  
si stuhia n'maje t'malit, mbi ta reshë.  
I ka shkulun prej llogoresh në Gjabrricë,  
tue i shtimun rrugës qorre n'nji ngushticë.  
Val't e Drinit i kan' serbët ball' për ballë,  
veç me fletë se me krah' s'munden me dalë.  
Dali Lami u ka zan' para nji bugë  
edhe i pret ai nji nga nji si dhent në shtrugë,<sup>1)</sup>  
ja shkel kambzën, sa s'ja kputën, mitrolozit.  
Pak ma para ja kish marrun njaj digozit,<sup>2)</sup>  
i pik<sup>3)</sup> serbët sa në trap e sa mbi trap,  
n'bark e n'shpinë pesdhet' mbarë e pesdhet' prapë.

Mbi nji çuke po këndon Halil Selmani:  
«Bini, voca, Reç e Dardhë, ktij dushmani,  
t'mos i mbetet askund nami as nishani!»  
Pa sos kangën, Halil krosit iu ndal zani,  
dek' më tokë e kishte lanun kapidani.

---

1) shtrugë = derë vathe ku kalojnë dhentë një nga një.

2) digoz = njeri i mbrapshtë.

3) i pik = i qëllon.

Nën Halilin kishin mbet' dhe dy murana:<sup>1)</sup>  
Rexhep Troci e Rexhep Laçi lan' dy nana:  
kapidani kish qen' trim e shitoft' zana.

Dali Lami e Fali Troci rrin' në bark,  
tue e vrejtun kapidanin që nga lark.  
Shtrimun barkas tue pergjumun mbas njaj kepit,  
para tyne thik' po varej buza e shkrepit.  
Me gisht t'vogël, sa nji grim' me t'prek' njeri,  
pa ndesh' tokën bijshe n'Dri si kalkuri.<sup>2)</sup>

Ku përgjojshin Fali Troci e Dali Lami,  
her'n e parë n'shteg u doli kapidanin.  
Si ndoj kafshë kur e kap në fyt ariu,  
Dali Lami kapidanin e përfshiu.

Prej dardhjanve serbt' jan' futun posht' për  
lugu,  
sikur dhenët kur i ven përpara strugu.  
Lug i shtrembët, si me than' lugu i teneqes:  
«Kukuvica!»,<sup>3)</sup> t'gjith bërtasin prej së keqes.  
Tak-e tik-e iu kërset manzeri mbas,  
kujt në shpinë, kujt në shpatull si më rrasë.

Hasan Rama, Xhafer Sula djem të rrallë,  
le e rritun n'nji katund e n'nji mëhallë,  
shok't e tyne në kta male gjinden rrallë.  
Përmbas tyne vjen i treti Halim Lika,  
që nuk di, jo, se n'c'farë ane bie frika,  
tri vjet para kish luftue po në ktë vend  
me Xhavitin qysh në Lumë e në Prizrend.

1) murana = vorre.

2) kalkuri = mbeturinë ujnash.

3) kukuvica = kuku qyqe.

Prijs tue pasun n'luft' me turkun Baftjar Dodën,  
vranë asqerin, zabitllar't, këshllanë e dogjën.  
Të tre bashkë n'nji llogore, ke ligjata,<sup>1)</sup>  
kishin zanun dy kaseta me granata.  
Për n'njenë anë i kan dalë ushtris' përpara,  
ua zun' vendin ke ai kepi lara-lara.  
«Hajt, Hasan! — i tha Xhaferi — jepu flakë!»  
«Mos u ngut, Xhaf', sa t'na mblidhen edhe pak!  
N'cop' t'livadhit të mbështillen kompani,  
at me grada ta përgjojm' t'na hyj' n'pusi,  
atëherë t'ua vërdatim<sup>2)</sup> n'befasi!  
Tri granatat përnjihere ran' në grumbull:  
iu thye qafa, dhetë kaptina u banë rrumbull,  
u përleshën copa-copa e grima-grima,  
nji mbi tjetrin, n'Gryk' të Shkallës shkoi rënkimë.  
Bien granatat nji mbas tjetrës pa pushue,  
nga ky grumbull nji pér be s'mund me shptue.

Tabe m'tabe<sup>3)</sup> me lusnjan' Ramadan Ciku,  
katër tabe mbrend' sahatit krejt i fiku.  
N'krye të Lusnjës vetë i pari shkon si era,  
ndjek vanakun<sup>4)</sup> nji mbas njej ndër tabe tjera.

N'Bok' t'Mëholes nam po bajn' Kalizi e Vila,  
bokës s'thatë vesha-vesha, brryla-brryla.  
Shkundet boka kur ushtria del prej malit,  
sikur derrat kur trazohen prej moçalit:  
nishanhxitë i qellojnë midis kokës.  
S'mejn' kapotat tue ja fshimun pluhnin bokës.  
N'prue të vogël u stivosën turra-turra

1) ligjata = vend me uj.

2) t'ua vërdatim = t'u a hjedhim.

3) Tabe = pozicjon.

4) vanak = rrjesht.

si turr' drushë para se tē digjet furra.

Dan Zaskoci me Tejdrinë e an' t'Ujmishtit.  
njoht' nē Lumë brez mbas brezi pér hak t'gishtit.  
nëpér flakë lshon patare posht' te Canet,  
mbrend' sahatit i zaptuene istikamet.  
muer'n manzeret, te tre topat e xhephanet,  
lan' kapsolle, pushk't e gjata e shishanet.  
Batalionin gjysmën mbytë, gjysmën e shkulën.  
n'midis t'tymit mbi nji çuk' flamurin ngulën.

Me Bican e Kolasian Islam Spahia  
po vikaten: «Bini, djem, se shkoi Shqipnia.  
Bini, djem, a besa besë me hov me i ra,  
na ka hymun qeni i serbit n'cullë e n'gra,  
don t'na shkreti, fmitë e djepit asht tue i vra!»  
T'u lshue dheu nga gjith anësh zogori,<sup>1)</sup>  
sikur ujqit n'natë tē shndreut n'acari  
veshun tirq e koperane mbarë e prapë,  
nji n'opinga, njeni zbath', tietri n'corapë,  
msyejn' katundin nëpér qoshe e rrugica,  
kullë më kullë tak e tuk po ban petica,  
dikush njitei nëpér pemë e n'maj' t'çatisë.  
do tē tjerë i përgjojshin n'dyer t'avllisë.

Azis Xhafa i kish vù spatës bisht tē ri,  
e kish mprefun sa duhan me tē me gri.  
Rrokun spatën si babgjvshi i vet dikuri,  
me durim ai po vërgjon n'nji qoshe muri:  
her' me tef e her' me bisht u bien mbas kreje  
m'gjunj e m'krye rrukullimthi shkoin' pér meie.  
T'jan' mbush' Bicajt vend pér vendi shpi e vorre,  
truca<sup>2)</sup> t'dekunsh ba vakuf nëpér oborre.

1) zogori = tufë ujqish, lavë, lukuni.

2) truca = grumbuj.

Sheja<sup>1)</sup> e Luma<sup>2)</sup> kanë dalë shtratit prej tërbimit,  
kodra-kodra rrrokuillisen val't e Drinit,  
askërkundi s'mbeti urë as dru përki,<sup>3)</sup>  
ksi tallazi nuk ka ba ndojher' vaki!  
Mbetën serbët n'katër an' rrethue jesir,  
Mark Dushani kurr s'e pa vehten ma vshtirë.  
Para Sheia, në t'majtë Drini porsi det,  
mbrapa shpinës asht Gjabrrica thik' përpjetë,  
në të diathtë vjen Belesha krisha-krisa,  
njiqind herë po ma e keqe se Gjabrrica,  
n'kurrfar' mnyre nuk po dijn' ka i hjedhin kambët,  
se malsorët u kan' ra n'të katër anët:

Bieri Reçi e Derjani,  
bieri Vila e Bicani,  
si Ujmishi e Kolasiani:  
bier Kalizi edhe Bushtrica,  
bieri Luisna kah ngushtica!  
Jehoi krisma kah Tejdrina,  
doli Srroju me martina,  
peshë u çue e gjith krahina.  
Sipër breshën e vetëtima,  
me rrufe e bubullima,  
hikin serbët tue vrapiue  
si ndoi lepur i trazue:  
s'marrin vesh se kah po rendin,  
hic kërkund s'e njohin vendin!  
Kahdo sillen e kaloinë  
vec në plumbë po takoinë  
dhe kan' zanun të dyshojnë

---

1) Sheja = lumë.

2) Luma = lumë.

3) përkie = përsipër.

edhe tokës s'po i besojnë;  
rreth njimij' po ishin mbledhë.  
ku shkon Drini me t'përdredhë  
n'fund t'shkaurranit, 1) n'rreth t'potokut, 2)  
fut' në gji të shoku-shokut.  
Humb kapotat me gjith ksula,  
nji mbi tjetrin rrin' si pula.

Tinëz i ndoqi Uke Shkambi,  
tinëz u fut ai ke shkaurrani;  
me nji shkurre luen nji gur.  
T'jan' lshue kepat pa u furë<sup>3)</sup>  
si me u shembë pesqind pash mur!  
Kujt në shpatull, kujt më kokë,  
dikush rrasej në potok,  
kush te prroi mbet fund themeli,  
t'buzës ujt i mblodh Zhurreli! 4)  
Uke Shkambi ban gajret.  
krejt i mbyti njimij' vetë,  
pa qitë pushkë e pa fyshekë!  
Forcat tjera po qëndrojnë.  
gjith kto t'kqia po i durojnë,  
armët kurr nuk i dorzojnë.  
vec tek-tuk ndoi burracak.  
çë ka le i panafakë.  
Po kur mundin e i takojnë,  
me dor' t'vet i pushkatojnë.  
se kan' sedër e maras  
prej inatit duen me plasë.

- 
- 1) shkaurrani = shkrep i thepisun me grumbuj gurësh.  
2) potoku = tokë ranishte në rreth të Drinit.  
3) pa u furë = pa u ngucë.  
4) Zhurreli = degë e Drinit që hecën me rrëmbim.

M'an' tē Shejës shum' ushtri,  
kur e pan' vdekjen me sy,  
që t'mos bijn' rob n'dor' tē huej,  
dor' pér dore u mbytën n'ujë!  
Mark Dushani me pesmij'  
don me hap' nji shteg tē ri.  
N'rreth tē Shejës, nē nji bri,  
t'madh ka rrxue nji verri<sup>1)</sup>  
pér t'kalue n'drit' tē vettimës  
Shej'n e tmershme, i biri i shkinës.  
Sulë Salia e Kamber Musa  
po i përgjojn' nē dy gëmusha.  
Djem tē ri, tē dy bicana,<sup>2)</sup>  
veshë nē tirq' e xhamadana,  
vargje-vargje me gjajtana,  
mbathë më kambë opinga t'forta,  
lidhë mbi tirq tet' rrath' me norta,<sup>3)</sup>  
ksulat bardh si plati<sup>4)</sup> i borës,  
pes' plumbë kmisha n'koc tē dorës,  
nga dy pushkë e dy kollana,  
nga dy bume pér çdo ana,  
nga dy thika si maj' drapnit,  
lye gjith anësh m'zeher gjarpnit;  
t'dy musteqet kacadre,  
(ngrefen vetë kur zan' me u nxë!... ).  
graflue leshi sipér gjiut,  
hapun kmisha vetvetiut,  
C'po u vетojte shqema e syut!  
Kamber Musa, i pezmatue,  
memzi mundet me durue

---

1) verri = dru i madh lisi.

2) bicana = këtu: moshatarë.

3) norta = gjalmë që lidhen opingat.

4) plati i borës = këtu: shtrati i borës.

se 'i martinë iu hoq prej krahua  
n'Bok' t'Mëholes iu vra vllau:  
n'mitroloz ja grini shkau,  
e lëshoi përbys mbi dhe  
tue lan' t've nusen e re:  
sa kish ardhun fllanza e malit,  
s'i kish hek' paret e ballit!  
Kamber Musa e Sul Salia  
po durojnë sa t'nis' ushtria  
me kalue njishkolonë,  
kapë shoshoqin në pantollonë,  
duen me u mbajtun n'krande t'holla:  
s'i shpton Pjetri as Nikolla.  
Sheja posht' dredhon si bolla,  
me goj' hap' si nana e Drinit,  
pret të pikën<sup>1)</sup> prej verrinit  
sikur zogu n'goj' t'hutinit.  
T'i kan' prit' Sula e Kamberi  
t'dy manzeret përnjiheri!  
Kur kan' krisun dy manzere  
mbi vërri u dha potere:  
dy u vranë e dhet' s'u vranë:  
të gjith grumbull në Shej' ranë.  
Shpoi nji za hijen e territ;  
ishte zani i nji togerit,  
që ushtarët i kërcnonte  
dhe me forcë i detyronte  
t'mos e baishin fialën dy,  
por t'kalojshin mbi verri.  
T'gjith me radhë i porositë,  
nji mbas tietrit mos me u njitë:  
«Ato pushkë janë vetëm dy,

---

1) të pikën = këtu: të bien, të zbresin.

sado shpejt që kan' me shti,  
sado shum që do t'kërsasin,  
vetëm dy prej jush do t'verasin:  
ata t'dy pér kral do t'shkojnë,  
por të tjerët do t'kalojnë!»  
Zuni t'hypë rrjeshti i dytë  
tue i dridhun t'gjith kocitë.  
Kur i pari n'qosh ja mbrriti,  
Sula kresë ja tereziti...  
U vazhdue kështu pér terri:  
n'an' t'andejme i nis togeri,  
kndej prit Sula edhe Kamberi.  
Mbasi shkoi koha nji copë,  
edhe Sheja fort u ngop,  
vet' togeri na u nis  
tue i ndej' rrjeshtit pér midis.  
Gjysma e rrjeshtit rrshqiti e shkoi,  
gjysma tjetër tej kaloi.  
Toger Vuka u nis ke gurra,  
vetë i zgjedhun me tetë burra,  
ku kanë zanë Kamberi e Sula.  
Sul Salia e Kamber Musa  
po i përgjojshin ke gëmusha.  
T'u ndez pushka ke hendeku:  
Mark Dushanit iu çel shteku.  
Vukoviçi kishte thanë:  
«Pasha Kishat gjithsa janë  
veç të gjallë un' kam me i zanë!»  
N'rreth të ngushtë i ka rrethue,  
pushkë e bume tue ua lshue;  
po vin' rrethin tue e ngushtue,  
tue u hudh' barkas si kërmilli,  
dy shqiptarve s'po u humb filli.  
Jan' hudhë Sul's e Kamber Musës,  
katër pash afër gëmushës.

Lshoju bomba, t'shum'n e herës  
 prej t'pangimes u shkojn' ters.  
 N'vend se t'bien anës s'epër,  
 përmbi krye u shkojnë tepër.  
 Ku ranë bombat, gur't i shpuen;  
 njanitjetrin e faruen.  
 Atëherë toger Vukmani,  
 kërcei mbrend' ke istikami  
 e, pa folun asnji llaf,  
 Kamber Musës iu hodh n'qafë.  
 T'u përla Vuka e Kamberi  
 sikur shqipja e skifteri,  
 herë për krahash, herë për belash,  
 herë në shpinë edhe herë gjelash!  
 Boll i fortë kish qenë dhe Vuka,  
 ja kallzonte hija e duka.  
 Po Kamberi i tha Vukmanit:  
 «Un' jam rritë me mahe stani,  
 nuk më mposht dora e serbianit!»  
 Nxori thikën zeherlie  
 dhe ja nguli Vukës n'krye.  
 U vra Vuka, pushka joshi, 1)  
 ke Kamberi Sula sosi.  
 Dy të gjall' që kishin mbetë,  
 i përcollit n'ahiret! 2)  
 Me ksi djemsh që ka malsia,  
 nuk do t'shkretet kurr Shqipnia!

Duel agimi: n'horizont po fiken yjet,  
 përqark majet kishin zanë me ngritun kryet.  
 Maja e Rrunës me Gjallicë e Shkamb të Zepit,  
 sot buzqeshin kur i shofin shpinën serbit!

1) joshi = këtu pushoi.

2) ahiret = në botën përtej varrit (sipas fesë).

T'dymbdhettmijét që i panë pesë dit' pérpara  
tue mësyemun në livadhe e nëpër ara,  
sot i shofin t'sakatue tre çerekë,  
dhe çereku ishte ba me u lidh' n'lyrekë.<sup>1)</sup>  
Por nji fjalë prej të parve kem ndëgjue,  
se kur bisha bri pér bri asht e plague,  
atëherë t'keshë kujdes edhe t'i druhesh,  
kur jep shpirtin t'i rrish larg e shum t'i ruehesh:  
po ta njiti, n'anën tjetër t'i puq dhambët,  
të pérpin e hiç në tok' s'të prekin kambët.

Mark Dushani n'Rrahanij' tue lef si qen,  
vjen vërdall e nuk po i zen jo vendi vend.  
N'breg të Shejës saltanetet kishte vgjerrë,  
humbë nishanet, kmisha grisë, pantollat çjerrë!  
M'an' të rrahut m'të veçue ke do ferra,  
vrik e vrik seç i ka thirr' dy oficera.

«N'emën timin — menjihere i tha të parit  
je ngarkue me detyr'n e kumandarit!  
Në katundet që kem' para nisu fill,  
venu pishat, nëpér dyer i bani vgjillë!»  
Kurse t'dytit i bërtiti me tèrbim:  
«Ç'më rri vokët si me m'ardh' pér transferim!  
Bjer borijes menjiherë e mblidh ushtarët,  
ktu t'm'i sjellish ata t'dyzet kosovarët!»

N'fund të rrahut, më nji skutë mbi do rranjë  
ahash,  
ishin ulun kosovarët lidh' pér krahash.  
Të rrëthue n'katër rrathë, si rrath't e shekës,  
prej nëntoke po i thirrte zani i dekës.  
T'treqind grykat presin kamzat me ua shkelë.  
të dyzetve n'zeher trupat me u mbjellë.

1) lyrekë = fasha.

Mark Dushani u kërcnohet aty parit  
si xhelati para shkambit të litarit.

Tue shkreptimun si lugati nëpër dhambë,  
kosovarve kështu nisi e u ka thanë:

«Me shqiptarët tinës jeni marrun vesht,  
armët tueja për gjat' frontit kan' pas' heshtë.  
Unë e di, po, se ju jeni kosovarë,  
porse kurrë nuk mund t'jeni ju shqiptarë!  
Prej kabilës<sup>1)</sup> juve jeni turçeli,  
mysliman' prej Anadollit, osmanllij!»

Mes dyzetve Mark Dushani njej i foli:

«Zgjidhnia duerët! Çou në kamb' ti, Ram  
Sokoli!

Të kam falun e të shkosh n'Llap e Gallap,  
fjal't e mia n'gjith Kosovën ke me i hapë!  
Ke rren' mendja se s'jam turk, por jam shqiptar,  
n'lisa t'malit të tan' kemi për t'i varë!»

Prej së largu n'mes të shokve Ram Sokoli,  
trup i gjatë drejtë përpjetë si maje mali,  
prej sertnie<sup>2)</sup> rrudhun balli dredha dredha,  
vesh e n'vesh pjekë i janë mustak't e zeza,  
sytë përgjakun për nën vetull kuq si alli,  
Mark Dushanin do ta hajë për së gjalli.

«Gospodare! Njato llafe merri prap,  
Nuk kanë vend as në Kosovë as në Gallap!  
Ne nuk jemi turçeli anadollakë,  
babë e gjysha i kem' pas' shqiptar me flakë,  
me shqiptarët ne s'u lidhëm mbramë për hane,

---

1) kabilës = origjinës (turq.).

2) sertnie = ashpërsie.

por prej diellit kur u pikëm prej njej nane!  
 Edhe gjaku që na rrjedh nëpër damarë,  
 asht i Shqypes, i kullue gjak shqiptar,  
 që ka vluet tef më tef me shpat' t Muratit.  
 pesqind vjet deri n'koh' t'Sultani Reshatit.  
 kundër turkut kem qenë krah i Beligradit!  
 Ne shqiptarët me Serbi e Karadak,  
 kundër turkut kemi qenë të tre ortakë,  
 si tre vllazën n'nji llogore derdhëm gjak!  
 Në kryengritje të dymbdhetes mbar' Kosova  
 para botës edhe i herë e dha me prova.  
 Por t'pabesë ju paskit qenë, or t'bijt e shkinës,  
 n't'pa kujtue na ngul't thikën mbrapa shpinës!  
 At liri që e fituam me krahanuer,  
 na e rrëmbyet sikur bishat nëpër duer!  
 Sot na folni veç me llapën e padronit,  
 na mohoni t'drejt'n e gjuhës dhe të kombit,  
 tanë Kosovën e lëshuet në gjak të ri,  
 tue i pre trimat dy a tre sa ka për shpi,  
 tu' u marr' mallin, tue i qitë muhaxhiri,  
 pa u tanue<sup>1)</sup> pa u pasë as gjak as varrë!  
 Drit'n e syve ju dushmanë na e keni marrë!  
 Qenka thanun ditë me sy ne mos me pa,  
 ç'asht shqiptar veç prej pushke për me u vra!  
 Për Shqipninë pesqind vjet ne mbetëm lera,<sup>2)</sup>  
 por Kosova do t'qendroj' dhe mijë t'tjera!  
 N'tok' për s'gjallit sikur njerzit ti t'i ngulish,  
 në Kosovë rranij'n e Shqypes s'mund ta shkulish,  
 në vllavrasje kurr s'do t'mundish t'na vërsulish!  
 Kralat tu dhe sikur t'rrojn' sa qyqja e kuqe,  
 edhe myshku t'u ket' mbij përbimi kapuhe,

---

1) tanue = pa u prekë, pa u nga.

2) lera = këtu: grumbuj gurësh.

në Kosovë s'kan' me gjetun sofër t'shtrueme,  
sytë e tyne s'kanë me pa armë të palueme!  
Gjakun tonë nuk do t'gjindet shi me e la  
as dhe diell nuk do t'bjerë për ta tha!  
Her'n e fundit dhe nji fjalë jam tue ta thanë,  
unë i pari, shok't e mi tridhet e nandë:  
U thuej kralit kosovar't ma mos me i ndjekun,  
se n'çdo hap ka për t'u ndeshë me t'gjallë e t' dekun!  
Kocijt' tonë kanë me u ngritë prej vorrit t'zi  
n'fushë t'Kosovës do t'përleshën përsëri!»

Ramë Sokoli drejt iu lshue Mark Dushanit,  
sikur ujku kur përmblidhet dashit t'stanit.  
Ta kish zanun ja pat qitë gërmazin jashtë,  
lkur'n e tij pat m'e rjepë e mbushë me kashtë.  
Por e mpini mitrolozi nga nji qosh,  
pesë okë plumba ja banë Ramës trupin shoshë,  
me t'dy duerët mblodhi n'grusht ai zorr't e barkut,  
pa pikë fryme kryet i ra ke kamb't e Markut.

Shok't e Ramës u coptuen porsi berra,  
prrenjt' e gjakut rrahun çanë e ranë në vgjerra.

Gjaku i kuq tue grafullue vala vala,  
deri nalt n'maje t'Gjalicës çoi stërkala.

5

Bugës s'Lumës bie shiu reja reja,  
mbi Pobregë po del tymi meja meja.

Tym i dalë nga petka shtrati,  
tym prej ark's me ndrrësa shtati,  
tym prej trenësh e prej demësh,  
tym prej magje e kosha enësh,  
tym prej bletësh ndër kashune,  
tym prej misrit ndër babune,

tym prej lopve n'aharni,<sup>1)</sup>  
tym prej vathnash me bagti,  
tym prej pleqësh mbetë kërcu,  
tym prej djepash të shkrumbu!

Po del tymi tue piskatë nga shum katunde,  
kjo piskamë shum po i ther' do zemra Lume.  
Kjo piskamë theri plakun Halim Shehi,  
gjashtdhetë vejc ai e ka rrokë kosën për tehi.  
Duel prej Shtiqne,<sup>2)</sup> shkoi te çarri i Staf Delisë,<sup>3)</sup>  
e drodh kosën si n'llivadhe të kojrisë,<sup>4)</sup>  
drejtë në kambë tue kositë n'ushtarë t'Serbisë.  
S'pushon kosa nëpër lisa tue vringllue  
para plakut ushtar't ikin të tmerue.  
Mbas nji buge i qe mshehun Brankoviçi,  
thik'n e gjatë e kish qitun prej këlliçi,  
me dredhi i del Halimit mbrapa lisit,  
ja lshoi thikën për ta kputun për midisit.  
Halim Shehi n'bisht të synit e hetoi,  
drunë e kosës e përdori si mburojë,  
u plague porse vdekjes i shpëtoi.  
Gjak e djersë fytyr's i shkojn' Halimit vjerrë,  
n'xhep t'kopranes vrik kutinë e paska nxjerrë:  
për ta shndoshun i vu plagës, n'vend t'mehlemit,  
nji dorë pluhun me burrnot<sup>5)</sup> me duhan vendit.  
N'vend të fashos, të shamisë a kindit t'vjetër,  
përmbi pluhun sipër plagës vu nji letër.  
Dy sahat u shkundën lisat krejt me radhë

---

1) aharni = burg lopësh (bagëtish).

2) Shtiqne = fshat.

3) Çarri i Staf Delisë = emën vendi.

4) Kojri = tokë e gjithë katundit.

5) Burrnot = pluhun duhani.

Halim Shehi tue luftue me plagë më ballë,  
ja josh gjakun veç duhani e letra e bardhë.

Mbas Halimit po na i shkueka dhe nji djalë.  
I shtiqanë qenka ky Shaqir Dauti,  
gjith at ditë pér me dekë Zotit i luti.  
Me Halimin zunë ke lisi në bushti<sup>1)</sup>  
tue përgjue pér me u ndeshun me zapti,<sup>2)</sup>  
me zaptie fund me i dhanun jetës s'vet:  
me t'përpjekun jan' ndesh' kosë e bajonetë.  
Mbenë Halimi dhe Shaqiri në bushti,  
Shqerrë me thika me zaptiet gji pér gji.

Hec piskama nëpér re e muer havaja,  
ndër malsorët e shpérndau der ke bugaja.  
Kjo piskama ke malsorët shtoi mëni,  
mnia e thellë, besa, fort u dha fuqi,  
u dha forcë sa fuqia e ortekut,  
tue fshi serb't prej çdo shkurje e prej çdo shtekut.

Lloj lloj britmash shqirrin retë që janë hava,  
britma e Lumës asht përzie me bugà,  
britma kuajsh e britma qeshë me patkoj,  
britma serbësh e shqiptar'sh tue u rjep' me thoj.

N'krye t'bugasë, që zen fillin ke Gestili,  
vikamë t'madhe lshoi malsorve Suf Xhelili:

«Ne Skënderi na e ka lanun amanet,  
kur shqiptari n'fush' t'mejdanit ka me mbetë,  
duhet t'shkoje gjak pér gjak me njizet vetë!»  
Shkoi vikama gojë më gojë nëpér malsorë:  
«A besë, burra, kush me pushkë e kush me dorë!

---

1) Bushti = dushk i shpeshtë.

2) Zapti = ushëarë.

Baki Maliqi e Jakup Tota,  
Selman Lushi e Shaban Coka,  
Dan Koldashi e Hajzar Gjoka,  
Rrem Brahimi e Isuf Coka:

ke dy buga mes zabelit, n'jni kodrinë,  
tetë malsorët janë afroemun shpin' pér shpinë.  
S'asht zakoni pér me i kthyemun hasmit shpinën,  
mbas kurrizit t' t'fus' bajnetë o martinën,  
por zakoni i shqiptarit dhe i malsorit,  
asht me i dhanun vetëm drrasën e krahnorit.  
T'tetë malsorët, sikur burrat e zamanit,  
n'kambë qëndruen der n' fyshekun n'fund t'kollanit.  
Her'n e fundit kur iu ndal zjarri ke tyta,  
pun'n e zjarrit mbi shum krenë e bani qyta.  
Mbi të tetët u hodh gjysmë kompanie,  
u përzien kush pér fund e kush përkie,  
tetë malsorët grima grima i kan' shkafnie. 1)  
N'bajoneta shqerrun tirq e xhamadana,  
n'mes t'bugasë n'grumbuj gursh u banë murana.  
Mbenë murana tetë malsorët, të tetët trima:  
në Serbi thellë përloten dyqind shkina!

Hik ushtria pér bugasë e posht' pér lethi,  
n'pikë të vrapi porsi lopt' kur i ze zekthi.  
M'uj të Lumës janë të parët që po hikin,  
m'qosh të rrafshës s'e përgjon i pari t'dytin.  
Ramë Ciku pushkën n'dorë e n'brekë e n'kmishë,  
bregut t'lumit mbrapa Markut ban yrysh;  
don m'e zanun dhe me i ngranun nji cop' mish.  
Pér nën Shtiqen Hysen Daci me nahi  
s'po ja ndalën: pre n'zabel e qit n'kojri!

1) shkafni = coptue.

M'at an' t'Lumës Dan Zaskoci n'kep të Gjahut,  
ushtrisë s'kralit ja ka marr' gjysmën e krahut:  
për nga bjeshkët të tan' shpresat ua ka humbë:  
o t'dorzohen ose krejt me u mbytë në Lumë.

Elez Isufi i vikati Uke Shkambit:  
«Baniu za Xhafer Dodës dhe Islamit,  
coniu fjalë edhe Sen's e Ramadanit,  
forcat serbe tashma janë në sahat t'fundit,  
asnji kambë t'mos na dalë pértej lumi!»  
T'gjith zaptiet që u kapën fundit t'arve,  
t'pushkatohen për hakmarrje t'kosovarve!  
Nji gja vehtes kurrnjihë s'do t'ja fali:  
Mark Dushani me më shkue gjall' te krali!  
Porositni krejt me radhë çdo malsor,  
të mos vritet, por i gjall' t'kapat me dorë!  
Hajdeni, voca! bini pra pér t'fundit herë:  
dita e nesme ka me qenë pér ne pranverë!»

«Besa besë!» përnjihë u ndeshën zanat,  
rrasën ksulat, i zberthyen xhamadanat,  
t'u përmblodhën gjith njiherë më katër anat.  
Ndër malsorë ja filloj pushka e vikama,  
ndër ushtarë në çdo shpinë kërset rropama,  
në çdo pllambë, në buga, në krande t'thata,  
para e mbrapa kërset gjylja dhe granata,  
sikur dhelpna kur i pik në degë pulat,  
m'qosh t'bugasë tue iu pikë ushtarve ksulat.  
Bash si dosat kur hyjn' dushkun tue e çà,  
shkojnë zaptiet tue e ba vendin rrugë. 1)  
Tetshe-tetshe shkojnë ushtarët bregut t'zallit,  
të ngushtue e të dalë n'pik' të hallit:

1) rrugë = lisa të premë e të shtruem përdhe.

se shkon Luma buzë për buzë e me furi,  
sjell murrani pa pushue borë e shi:  
strupuj-strupuj 1) me tallaze plasen valat,  
ne t'dy anët n'faqe t'shkambit shkojnë stërkalat.  
Disa qinde po rrinë lumën tue e pa,  
nga hec Luma drejtë te poshtë nisin me nga,  
se mos gjejnë, ban vaki, ndokundi va.  
Ku po piqet Drini i Bardh' me ujt' e Lumës,  
njaty pari ka pasë ur' me dru të bugës.  
Qvsh në Dibër, Dukagiin e n'male t'Krumës,  
atij vendi po na i thojshin Kulla e Lumës.

## 6

Mun ke kulla ku po derdhet Luma n'Dri,  
Mark Dushani grumbullue ka shumë ushtri.  
Për të fundit provon forc'n e kumandarit:  
sipër Lumës don me ba nji ur' litarit.  
Por malsorët koperanet i kan' vdeshë,  
der në brryla të tanë krahët kanë përveshë.  
T'u ndez flaka mun ke kulla, ke rrëpina,  
flakë granatash tue ba dritë nëpër celina, 2)  
copa predhash tue u kërveshun në turina,  
kambë e krahë hallakatë nëpër lëndina.  
N'batalione sa mund vjellin karajfilet,  
m'kullë të Lumës n'topa t'vet ua hqedhin gjylet.  
Mitrolozat që kanë zanun gjatë betejës  
në Gjabrricë, në bugà e n'lum të Shejës,  
qethin zallin nëpër ranë e nëpër cokla, 3)  
shpojnë kapotat në xhaketë e mbrijnë në kokla. 4)

---

1) strupuj = lamsha.

2) celinë = vend i fortë, pa gurë.

3) cokla = gurë zalli.

4) kokla = veshke.

Zallit t'Lumës regimentet, pat 1) i zi,  
Kanë mbetun sikur tufa pa bari.  
N'kët dor' dite 2) sot ka mbetë ushtria e kralit  
për drejt Kullës tue u shkrye në ranë të zallit.  
Po kur flaka zu t'u ndezi nëpër flokë,  
nga gjith anësh po iu vinte era tokë;  
për nën kambë ja filloj tue u hap' zhavorri,  
vetveti zunë tue çelun gropë vorri.  
Si bretkocat, kur i tremben ndonjë njeri,  
zhab'n e barkut e përplasin mbrenda n'vi,  
nji sekondë pa e pritun njena tjetrën,  
pa e kthye kokën me e pamë e reja t'vjetrën,  
n'uj' të Lumës njashtu hudhen krejt ushtria,  
n'valë t'tallazit tue u valvit' si kalkuria.

Sa po vinte e ma shum po shtohej Luma  
ujë e gjak, po krejt e kuqe dilte shkumba.  
T'u mbush Luma der te Kulla breza-breza  
si t'qenë mbytun dymij dhen, po dele t'zeza.  
S'pushon Luma tue i dhanë Drinit ushtri,  
ja ndrrroi lkuren, Dri'n e Bardhë e bani t'zi.

Mark Dushani ka marrë hov në pik' të vraptit.  
mjkra e zezë tue i dridh' si mjekër sqapit.  
Flok't e thinjun ja përzien kah fryn murrani,  
i tund vithet si me qenun kal karvani.  
Ka humb' shtabin, krejt i mbetën oficerat,  
kuajt e shalës kanë thye qafën me gjith kerrat,  
pushka e fundit që i ka mbet' Markut ksaj radhë:  
me i mbathun kamb't e lehta e faqja e bardhë!

---

1) pat = kopë.

2) n'ket dorë dite = në kët ditë, në kët gjendje.

N'rreth tē Lumës vuni kambën më nji tume,<sup>1)</sup>  
përreth Lumës shkunden shlegjet pushkë e bume!  
Uke Shkambi, tue iu hudhë m'e rrokë në fyt,  
kcei nga tumja, n'valë tē Lumës thellë u zhyt.  
Fill mbas Markut, kambë mbas kambe, u hodh Uki:  
n'faqe t'ujit tash asnjeni ma s'po duki.  
Shum i regjun kishte qenun fort jeziti,  
pse mbi ujë tepër rrallë ai kryet e qiti.  
Ùkja n'ujë e Ramadani në celinë,  
sa herë dukej e shënone në martinë.  
Dallga e valve e përzjeu at me zaptie:  
thonë se gjallë s'ka arritun në Serbie.

Për serbianët rrallë mund t'vijë kso dite kobit  
sa me u bamun hukubet krejt trupi i robit.  
Më tē thatë tue u hekë zalli nën kambë,  
nëpër ujë tue i rrafë tallazi i gjanë,  
gojë e veshë tue i mbushë me zallë e ranë.

T'kem t'i shifte qekso soji krali vetë,  
si flijohen në tokë t'huej ushtar't e shkretë  
dhe ta shifte bash vetë syni i gospodarit  
sa e madhe asht urejtja e shqiptarit,  
po t'i shkosh n'kolir tē zjarmit e t'caranit<sup>2)</sup>  
pse à i vogël, me i pushtue tok'n e vatanit,  
vendi n'vend nuk do ta zinte dhe n'Serbi,  
do t'tmerohej, lepri n'bark do t'kish me i hi,  
me gojë t'veten do ta linte me t'mallkue:  
me shqiptarët kush asht serb mos me u ngatrrue!

Prej dymbdhëtësh nja njimij', po duen me thanë,  
hodhën lumin dhe qëndrojnë me shpirt ndër dhambë.

---

1) tume = bokë, vend i mgritur.

2) kolir tē zjarrit e t'caranit = këtu: në vatër, në vend  
të tij.

Po përpigen nëpër kodra tue u tjerrë:  
duen me bamun nji furrik nën Ùk të Vjerrë.<sup>1)</sup>  
Po malsorët iu vunë zjarrin n'dushke t'gjedhit,  
ndriti nata sikur natën e Shëngjergjit.  
N'ara t'Pecit, ndér shullane t'Mathit t'Bardhë<sup>2)</sup>  
kërkllon shpati si rrënim i Reç e Dardhë.  
N'Ùk të Vjerrë, breg e m'breg katér bajrakë  
po vërviten t'egërsue si ujqt më gjak.  
Gra e cullë janë bashkue me luftëtarë,  
n'luftë me hasëm ranë me dekë populli mbarë.

Spatë e kmesat i kanë rrokë e po i shkadhisin,  
kambë e krahësh si me pre me dega lisin.  
Nëpër gryka prej shum zanesh del ushtima,  
za malsorësh tue u reshë nëpër lugina,  
vritma serbësh tue iu dridhë trupi me kina.<sup>3)</sup>  
Kur goditen, n'are t'qiellit shkon ulrima;  
ndonji t'gjallë, që teaproj, e shptoi errsina.

## 7

Kaloi nata; zbardi drita, ndriti vendi,  
ndriti Rruna me Gjalicë edhe Shkëlzeni.  
Krejt e kaltërt sot ka gdhimun kupa e qiellit,  
begatore<sup>4)</sup> e ngrof tokën rrezia e diellit.  
Qekso dielli rrallë po len n'ditë të dhjetorit,  
rreze t'arta si me qenië mesi i qershorit.

Lumiejt mbarë kan' ul' zanin s'ulurojnë,  
prrenjt e grykat tash kanë heshtë e s'po gjëmojnë.

1) Uku i Vjerrë = emën vendi.

2) Mathi i Bardhë = emën vendi.

3) kina = petka.

4) begatore = e begatëshme.

N'Kolasian e m'Uk të Vjerrë ka mbetë ushtria,  
ka ra heshtja, vendin zap e ban qetsia.  
Duken t'vramit për çdo shkurre e çdo gëmushë  
si kanicat<sup>1)</sup> kur derdh era nëpër fushë;  
me i numruemun besa kurr s'do t'mundet kush.  
N'katër anët toka shtrue qylym i zi,  
trupa serbësh jo ma pak se dymbdhetmijë,  
Në zabele, nëpër çuka e rrëkena,  
zall e shpate e lugina mbjellë me krena,  
pllambë për pllambë mbjellë për faqe nji sira,  
ndër do shtigje grumbullue e ba kala,  
nji mbi tjetrin mbetë në shpinë të shoqishoqit,  
renda-renda porsi duejt e kollomoqit.

Më do vise, më ndoj shpat a në rrafshinë  
gjith at heshtje prish dikundi ndoj rënkim.  
Ndoj i shitue që ka marrë ndoj plagë të randë  
sa mund hiqet e përpiqet shpirt me dhanë.  
Rrallë më t'rallë më ndoj kep a rrugë tërthuer  
shef të vramun a të shqerrun ndoj malsuer.  
T'dymbdhetmijët lanë i kanë armët viran  
truca-truca në Bardhoc e n'Kolasian.  
Çka qenë topa u ka ra gjylja ke rrrota,  
tanë xhephanet<sup>2)</sup> ngarkue mbetën ndër karroca.  
Çuke m'çuke fakllojnë pushkë e bajoneta,  
mbenë jetime dymbdhetmij hise të shkreta,  
hise t'shkreta dymbdhetmij' armë pa cuba,  
hise t'shkreta dymbdhetmij' nana në rruga,  
hise t'shkreta dymbdhetmij' nuse pa burra,  
hise t'shkreta dymbdhetmij' oxhakë pa tym,

---

1) kanicë = dorzë me kashtë thekne.

2) xhephanet = këtu: munizione (turqisht).

hise t'shkreta dymbdhetmij' konaqe shqimë:  
me t'dymbdhetët mbenë dhe Vllado e Milani:  
n'dhé të huejin pa exhel<sup>1)</sup> iu ba kurbani.

8

Rrjesht zjarmoret ishin ndezë në mal të qetë,  
Pal't e flakës pahit era lehtë e lehtë,  
pérreth roges<sup>2)</sup> valle-valle si kunorë:  
rreth e m'rreth janë qarkue trimat malsorë:  
dikush ngrofën kraharorin e zbërthye,  
dikush shpinën pérreth prushit e ka kthye,  
dikush qetë ndonji livere<sup>3)</sup> pér ta tha,  
dikush tjetër mbush kollanin dy sira.

Elez Isufi me gjith krenë të vegjëlisë,  
janë drejtue dhe kanë dalë në mes t'kojrisë,  
Dan Zaskoci më të djathtë i rrin Elezit,  
dy kollana: nji pér qafë e nji pér brezit.  
Pérmbas tij vjen Xhafer Doda shpatullgjani  
kah vloj pushka, besa, vetë i pari rrani;  
Ramë Ciku, trup të lehtë si skifteri,  
n'jet' të vet kurrë bosh<sup>s'i</sup> shnoi manzeri.  
Pérmbas tyne Senë Daci e Suf Xhelili  
mustakkuqi bash si gjethe trandafili.  
Me kta krenë sot nuk asht Islam Spahia;  
brij' në brinjë plag' të thellë i dha Serbia.

Elez Isufi fytyrzeshkët, vetullzi,  
burr' pa tufa,<sup>4)</sup> por krenar, tollosumli,<sup>5)</sup>

---

1) pa exhel = pa vdekje të parakohëshme (turq.).

2) roges = livadh midis pyllit;

3) livere = këtu: shami e madhe.

4) pa tufa = pa zhurmë, pa fjalë shumë.

5) tollosumli = autoritar.

karshi hasmish n'jetë tē jet's i panënshtre,  
me t'pabesët grykë pér grykë e thue më thue,  
me malsorët ndan përgjysmë nji lethi,  
tan' malsia be po bajn' më kok'n e tij.  
N'mes t'malsorve i pathyeshëm iu duk veti,  
n'emën t'kombit ja ka nisë t'i përshëndeti:

«Ju lumtë pushka, ju mor trimat e malsisë,  
zbardhët faqen, Lumës, Dibrës dhe Shqipnisë,  
latë postahe<sup>1)</sup> divizionet e Serbisë!

Skënderbegut ju ja mbajtë<sup>2)</sup> nji porosi:  
njimij' huta kanë gropue dymbdhëtmijë!  
Dgjoni, burra! Do ju kujtojë dita e sodit  
pér kto brinjë që ja thyet ju kralit t'serbit!

Do t'ju marrë historia, s'do t'harrohet  
lufta e juej, brez mbas brezit do t'kujtohet!

Do t'kujtohet trimi i ramë Halil Selmani,  
pushkë e kangë pa ja ndalë ke istikami;  
do t'kujtohet trimi i rrallë Halim Shehi,  
me nji kosë mbi dushman dufin shkrehi;  
do t'kujtohen Selman Lushi e Shaban Coka,  
Nexhip Visha, Rexhep Troci e Jakup Tota,  
Shaqir Dauti, Rexhep Laçi e Hajzar Gjoka!

S'do t'harrohet trimi i gjallë Uke Shkambi,  
që dërmoji njimij' serbë ke shkaurrani!

S'do t'harrohen Kamber Musa e Sul Salia:  
mbushën Shejen nji sahat me postaqia!<sup>2)</sup>  
Nuk harrohen Haziz Xhaferi e Dali Lami,  
Hasan Rama, Xhafer Sula e Fal Kasami  
e shum tjerë që po prehen nën murana,  
por shqiptarët pér kso ditsh i rriti nana!

T'mos i mbetet kujt merak sepse ne mbesim,

---

1) postahe = lëkurë e regjun me kryp (postaqe).

2) postaqia = këtu: trupa armiqsh.

për dhé tonin burrë e grue krejt do t'vdesim!

Kujt: — Aman, ti mos na nga! —, ne nuk i thona,  
qoftë kjo Athina, Beligradi apo Roma,  
se luftojmë veç pér komb e troje tona!»

Mbas Elezit ndër malsorë u ndie nji za:  
«Dgjoni kang'n e Kolasianit që e kan' ba!  
Xhem Sadria vetë e bani e do ta kndoje,  
veç i lumshin të dy krahët me gjith gojë!»  
Kur ja thirri sa n'krye pati kangës trimi,  
ndër malsorë zemra t'reja përtërini:

«Kndojn' gazetat n'Rumeli,  
n'Prizrend serbi paska hi!  
Ka zanë serbi Prizerentin,  
po i thotë Lumës: «Lirom' vendin!  
Lirom' vend', lirom' vatanin!»  
Reç e Dardhë zunë Kolasianin!  
«Qëndro pak, lumi Bican,  
se bes'n e Zotit që t'kam dhanë  
besa vetëm s'kam me t'lanel!»  
Kur vikati Halil Selmani  
«Bini, burra, ktij dushmani!»,  
ushtoi zani i Ramadanit:  
«Bini, djem, hasmit t'vatanit!»  
Po bërtet Islam Spahia:  
«Bini, djem, se shkoi Shqipnia!»  
Të tre zanet shkojnë hava:  
«Bini, djem me hov me i ra,  
ka hy serbi n'cullë e n'gra,  
fmijtë e djepit asht tue i vra!»

Kur u ngreh poplli kundrejt,  
mbenë askeri hukubet.

Kërset pushka, merr gjamë kepi,  
sot pér kral u ba kjameti!

Gjet kjameti kral'n e zi,

shkel Elezi me malsi.  
Kërset pushka dridhet toka  
shtinë Elezi me dy topa,  
Me dy topa shtinë Elezi,  
krejt në sulm u hodh mileti.  
Sulmoi Lumë e Dardhë e Reç  
sot për kral mos Zot ma keq.  
Sheja e Luma po shkojnë gjak,  
po i thonë Drinit: «Ndihmomë pak!»  
Krali i serbit ban medet:  
«ma faruenë asqerin krejt!  
Ma faruen asqer'n e ngratë,  
burrat n'pushkë e grat' me spatë,  
nuk erdh nji në Beligrat!  
S'ma lanë nji në shpi me shkue,  
fjalë ke nana për me çue!»

Ky kral Petri po mban zi:  
«Un në Lum' s'po muej me hi,  
m'prenë asqerin dymbdhetmij!»

Krali i serbit mend hava,  
toka jonë nuk asht mera  
që të mbledhish dhen e dhi  
e t'i lshosh ti pa bari!  
Mbaje cakun ku e ke  
tjetër herë mo' u kap me ne:  
po t'lakmosh me na marrë tokën,  
në Shqipni do ta bajm' gropën!

Peshkopi 1965

## NË SULM PËRMBI BARIKADA!

Rinisë, në 20-vjetorin e saj

Kur gozhda e çizmes fashiste  
e pruli shqiponjën n'kurris  
dhe zemra e tokës shqiptare  
me hekur po çuhej n'midis;  
kur ajri i mbushun me zeher,  
nga gryka ne frymën ne e muer  
dhe rrasat e zeza të tokës  
kulshedra i kapi me duer;  
kur Shqipja jonë peng mbeti  
e shtangun, mbërthyte me sopata  
dhe vaji i foshnjës ndër riza  
me britëm i shkonte përmbrapa;  
kur malet dhe fushat rënkojshin  
nga pesha e barrës s'pamasë  
dhe guri në mes të lëndinës  
prej vuejtjes përpinqej me plasë,  
si dufi i erës s'Tomorit  
jehonë lshoi zani i Partisë  
dhe t'vdekmin e lvizi nga vorri,  
«Mbi tanksa!» i thirri Rinisë.

Mbi tanksa! Mbi hekur të zi!  
Me grushtet e tua t'i shkrijsh;

me vrullin e revolucionit  
barbarin ta shkëpish për brish!  
Mbi kshtjellën e vjetër vërsulu,  
e ndeze e digje në flakë,  
me rrashtha le t'mbushen përrrenjët  
e mbyte fashizmin në gjak!  
Me gjokse të hapun si gjyshat,  
me krah' të përveshun me shpata,  
në sulm, o Rini e Shqipnisë!  
Në sulm-ë përmbi barikata!»

Si foshnja thith gjinin e nanës  
e thithën sokolat kushtrimin,  
e thellë n'damarët e gjakut  
e shkrojtën, rranjosën besimin:

«Me ty, o Parti Komuniste,  
sot lidhet i ri edhe i vjetër,  
me ty asht djelmnia shqiptare,  
veç fjal's që thue ti, nuk njef tjetër!  
Me emnin tand t'shenjtë në gojë  
bashkimin krijuem në Nandor:  
lam' bankat e punën, parmendën  
dhe rrokëm ne armët në dorë!»

Trimneshat e reja t'Shqipnisë  
e flakën tej perçen, e grisën!  
Me kang' të fitores në gojë  
tok luftës s'çlirimit ja nisën!  
U ndezën e shkurre e dëllia,  
sa tymi u shkoi në çdo shtek:  
me gjokse po çahen llogoret,  
nuk tuten jo trimat me vdekë!  
Të zbatun në borë edhe n'akull,  
në ferra me meja e me gropat...  
të shtimën e hutave tonat  
e ndjeu Ballkani, Europa!

Dhe gjaku i ngrohtë i rinisë  
qytete, katunde i lau  
e tymin e hidhun t'barutit,  
të kryqit të thyem e shpërndau,  
e strofkën e mykun të beut  
e tundi n'themel përgjithmonë  
dhe ylli i kuq i fitores  
shkëlqeu në qiellin tonë!

Si gj'mimi i fortë i rrufesë,  
tash zani i Enverit kumboi:

«Përvishuni pun's s'rindërtimit:  
mëngjesi i jetës agoi!  
Tash kanga dhe gazi hazdisen  
se t'keqen na e mori trishtimi  
dhe vendin e drunit e t'vrasjes  
për shekuj e zuni gjëzimi!»

Rini, o Rini kurr t'mos ndalet  
ai hovi yt triumfonjës.  
askurr ndonjihera t'mos imposhtet  
ai shpirti i yti krijonjës!  
Kurdo e kudo të ndëgjohet  
sot kanga e jetës së re;  
në punë, në shkolla, ndër ara  
ti diersën të derdhsh pér atdhe!  
Kudo, në çdo vepër, të duket  
e fort, si granit, dora jote,  
dhe mendja jote e shndoshë  
kudo t'truimfoj' gjëzimplotë!  
Në rrugën që t'çon n'Socializëm

ti vendin t'ja zeshi të së vjetërës,  
ti je shpresa e bukur e atdheut!  
Ti, ti je pranvera e jetës!

Mbi kockat e njoma t'Qemalit  
e t'mija të rinxve që ranë,  
djelmoshat dhe vashat krenare  
betimin e vet na e banë:

Me thirrje t'kushtimit t'Partisë  
dje rrökëm ne pushkët, granatat:  
për t'humbun ne gjurm't shkatrrimit  
sot rrokim e kazmat, lopatat!»

Thell' n'palc u ngul kazma dhe Dajti  
u shpue me shpejti anembanë,  
vrik shinat e para u lshuen,  
sirenat fishkellyen në Tiranë!  
U thye edhe shkrepi i Shkopetit,  
kënetat u thanë e shtërpunë  
e rrezet e hidrocentralit  
ne dritën bollëk na e prunë!  
Mëndafshi u end në pëlhura,  
sot tymi n'oxhaqe përdridhet,  
e gruni, panxhari, pambuku  
në tokat e reja po mblidhet;  
në rrugë, në shkolla, miniera,  
ke nafta, benzina me puse,  
krahnoret e gjana t'rinishë  
u mbushën me shenja sulmuese!

Kudo që ta hedhish shikimin  
asht gjurma dhe vula e rinisë;  
asht mundi, asht djersa si lumë  
t'rezerv's luftarake t'Partisë,

të ksaj fidanishte të njomë,  
filizat e ri i shpeshon,  
e radhët e nanës Parti;  
çdo ditë e çdo orë i forcon!

Partia pasqyr' e mendimit,  
e ndjenjave, e forcës së gjallë,  
këtë nuk e lkundin mashtrimet,  
tallazit i rri ball' përballë!  
Këtë nuk e trembin kërcnimet  
as rrezet e bomb's atomike,  
se gjaku dhemishi i saj  
asht pjekun me ndjenja fisnike!  
Ti ngjeshju, rini, n'gji t'Partisë,  
shtërngoje ma shum se çdo herë.  
Me gërma të ziarrta, t'çelnikta  
t'i shkruejsh fjal't-e shokut Enver:

«Ti rueje çdo dushk të Shqipnisë,  
ti rueje çdo gurë e lëndinë,  
ruej fushat e mbjellme me grunë,  
minierat, fabrikë e uzinë!  
Ruej valët e egra të detit  
t'mos vinë e t'përplasen pa i pa,  
ruej qielin prej sorrave t'zeza,  
asnji të mos mbetet hava;  
ruej ditët e bukra t'pranverës,  
ti rueje çdo plumbë të kufinit,  
ti rueje bashkimin me popull  
e rueje si beben e synit;  
se shtrigat kur rrudhen e plaken  
dhe kambët e veta s'i mbajnë,  
ndër krahet u ndalet fuqia,  
më gjuhë mundohen t'përçajnë!  
Bashkimini që kemi ta prishin

tash shtatëmbdhjet' vjet spiunojnë,  
me ftyra të ndyta si Temot  
bajrakun ne duen t'na e turpnojnë!  
Por kush asht mundue e mundohet  
me turp ta mbulojë Shqipninë,  
ke dera atij turpi i ka vajtun,  
me turp e paguen poshtërsinë!

Sot shtete t'Euroپ's e t'Balkanit  
me zjarrin në dor' na ngacmojnë,  
me flotën e mürime të Natos,  
me kunja raketash vringllojnë,  
me sy dhe me gojë të hapun,  
vërtiten e çirren, bërtasin,  
por para triminië ka le frika,  
në strofkat e tyne t'pëlcasin!  
Po! Ne kemi dashtun dhe duem,  
të lidhim, të kemi miqsi  
me miq e me shokë të pahile,  
që t'shoftin si vllaun ndër sy;  
por kurr jo me miq të tërthortë  
që sytë t'i mbajnë ke opingat,  
se kambve, thotë populli ynë,  
të shohin t'pabes't edhe shtrigat!  
Kush vehten mik tonin e quen,  
gjoja tue na dashtun t'mirën,  
a mundet t'i laj' shpres' Greqisë  
t'androjë për Vorio-Epiren?  
Kush asht komunist i shëndoshë,  
që don ne t'ndërtoim' socializmin,  
a mundet t'pajtohet me judët,  
me llumin e shitun Titizmin,  
kur sot në Shqipni i madh e i vogël  
të dalin dhe t'bainë dëshmi  
se numri ma i madhi i sniunve  
jan' kapun me lidhje n'Serbi?

Njaj miku i shpirtit e i zemrës  
a mundet t'veprojë si ky i fundit,  
me t'nxjerrun jasht' n'pik' të natës,  
t'ndërsejë edhe qent' e katundit?

A ban, vall', vaki me t'than' miku:  
«Ju urdhnat e mia zbatoni,  
për hatrin dhet trillet e mia  
të zotët e shpisë i rrëzojnë»,  
që gjakun dhe jetën e tyne,  
e ditët e bukra t'rini së,  
i vunë edhe i ven' në rreziqe  
për pamvarësinë e Shqipnisë?

O brezi ynë djaloshar,  
ju t'ri edhe t'reja veshroni:  
ju vuejtjet e gjyshit e t'babës  
në çastet e sotme kujtoni!  
I ri ti je sot, je filiz,  
por banu i thinjun n'mendim;  
të pastra ruej eshtnat e shokve  
dhe ti si ata banu trim!

Prej trimash ti rranjën e ke,  
prej brezash kshtu denbabaden,  
që n'dorë u lan' shpirtin xhelatve  
veç shqipe t'këndohet ky vend!  
Dhe trima jan' prisat e tu!  
T'vendosun për vdekje ne iemi,  
për rrethin e zjarmit të shpisë  
ne frikën asku jt s'ja kemi!  
Trimneshë ne sot kemi Partinë,  
që as hekur as zjarr nuk e tund,  
t'guximshme si populli ynë,  
që s'tremhet e asgia nuk e lkund!  
Në trupin e ksaj trimëneshe  
dhe sot shifen shenjat e plagve,  
por hecën gjithmonë përpara,

s'e ndalin as hovet e dallgve!  
E ballin e ka si fildishi,  
të ndritun, pa rrudha, pa njolla,  
e synin e ka si shkëndia  
si n'male ku njitet shqiponja!  
Të pastër ajo e ka zemrën,  
të zjarrtë si revolucion:  
Me ty, o Parti Fitintare,  
Rinia përpara marshon!

## SHPATE E XHVESHEME E KLASÉS PUNETORE

Kushtue Armës së Sigurimit të  
Shtetit me rastin e 20-vjetorit të  
krijimit të saj.

Si nga bjeshka, ku len serm ujt e burimit,  
nga Partia lindi Arma e Sigurimit.  
Lindi arma, shpatë e zveshme e klas's puntore,  
që mbas shpine iu fut hësmit ndër llogore,  
ndër llogore e deri n'shtabin e legjonit  
Sigurimi i shtini rrani't informacionit.

T'gjitha çarqet që fashizmi kish kurdisë,  
u shkrumbuen e plani i tyne ra përbys!

Dalngadale tue ja hequn dheun nën kambë,  
ra' Italja sikur bjen ndoj mal i tanë!

Mbas furtunës, n'vend që t'lind' dielli si pishë,  
zu nji breshën e çdo kok' na e nguli n'mish:  
divisionet e Gestapos me zinxhira,  
n'mitroloza na e ban' trupin bira bira.

Para u printe, n'rrugë e shtigje, pjella e vet:  
qent' e Ballit e nji rrym' Legalitet!  
Rrym' hafijesh, shpirtën t'krymbun, siç i thonë,  
që n'ball' dolën kundërpeshë e Frontit tonë!

Por zinxhirat edhe kurthet e Hitlerit,  
Sigurimi i ndërkambi përnjisherit  
dhe ushtria e çlirimit me rrebesch  
la «esesët» ndër bunkera dhamb' kërveshë!

Kur n'zjarr shkrini flaka jon' padront e vjetër,  
t'par't e Ballit gjetën shpejt padronin tjetër,  
që sajonte edhe ktù, n't'bukrën Shqipni,  
t'ngrinte krrabat e thertores si n'Greqi!

Vdiq fashizmi, u çlirue populli shqiptar,  
por mbas vdekjes korbi i zi na e la nji farë.  
Prej ksaj fare, gjys'n e thesit mbrendë e mbolli.  
gjysmën tjetër përtëj detit e përcolli.

Prej Munikut, Maltë, Athinë e Itali,  
me kta krymba polli 'jasht' dyzet parti,  
si «Liria» edhe nji «Shqipnia e Lirë»  
me Hasan Dostin e nji bej Ali Këlcyrë;  
«Parti Agrare», «Indipendent, Blloku Kombtar»,  
Gjon Markgjónaj, me Vërlac e bajraktarë!

Kjo llomhane u shpérnda ndër tarikate,  
tue u stërvitë për diversion e ditë e natë.

N'Federal Investigejsh, merrej mjeshtria,  
n'shkolla t'Simit e n'Athin' ke Asfalia,  
në Sërvis Intelixhenc të mshel' ndër shpella  
për Shqipninë ata kurdisnin plane t'errta.

Gjysma tjetër, që na e mbolli korbi mbrenida,  
qitën kokën, zun' tue u ba ferra me gjemba.  
Nuk shkoi gjatë dhe na mbini ferra e parë,  
faqja e zezë me klerik' «Bashkim Shqiptar».  
Të ndërsyemun ngaurrejtja e Vatikanit,

ngritten grushtin kundër popllit e vatanit; n'fjal' me grup të mbeturinës s'Riza Danit ata u lidhën me spiunin Fullc misterin tue marr' n'UNRA, si me i marrun gjarpnit zehrini.

Rranja e ferrës asht e keqe, rranjë e vjetër, tue pre njenën, menjicher' na mbin nji tjetër: mbini «Komiteti i Maleve» n'veri, komitet prej kriminelash më pari, që me bamun desh kryengritje t'armatosun e pushtetin popullor kshtu m'e varrosun.

Por vatani, t'gjith ata që e kan trahthue, mbredha i kalbi, kurr mbi tok' s'i ka durue!

Kështu i kalbi dhe për shkambi i përplasi aristokrat që n'grup i mblodhi Qeribashi, Abdyl Sharrën që, n'krye t'grupit t'sabotimit, minat vuni në themele t'rindërtimit, dhe nji «Front të Rezistencës» të hutue, që arm' mblidhët kundër popullit me luftue.

Kapitali i perëndimit gjuhëspec, kur e pa se qerrja e tij ktu nuk po hec, se ktu mbredha sharra n'gozhëdë i kishte ngecë, nga gjith kampet çoi e mblodh çdo lloj kopuku, m'nji rranz' meje kok', më kok' të gjith i struku, e u ra n'pre si n'ndojo tufë kur bie uku.

Amerika dhe Hinglizi, ma zengjina, zgjodh'n e morën desh të trashë — desh me brina. Disa t'tjerve u ra shortja shqerra t'thatë: vrapci i vogël, s'pa'n fuqi me shti inat...

Nji dit' para se t'i nisë për ktu jeziti, për çdo aendër i grupoi dhë i porositi: «Vrani e preni se ju sot e keni ditën,

jeni trima, p'r asnji jush s'e kemi frikën,  
ndihm' ju keni si Hingliz dhe Amerikën!  
Nuk shkon gjatë, jo ma shum se kjo pranverë,  
komunistët kem me i flak', me i hudhun n'erë  
e kulltukun do ta zini edhe 'i herë!

Por nji gja veç prej asnjenit t'mos harrohet:  
n'qoft' se vallja edhe rrëthi ju ngushtohet,  
të kaloni menjiherë në kufi  
te Broz Tita mbrenda në Jugosllavi.

Asht i yni mish e shpirt, sa e ka fuqinë:  
dora jonë sot drejton Jugosllavinë!

Asht përpjékun që në luftë e deri m'sot  
tue punue me shqiptarët «patriotë»,  
Koçi Xoxe, Pandi Kristo e të tjerë,  
q'ishin «burri», s'ishin njierz të pahaber!  
Ai ka derdhun e vazhdon me derdh' miliona,  
sot asht gati me sulmue me divizional!

Tashti nisi dhe kta urdhna t'i zbatoni!  
Ja dhe armët Shqipëninë ta «çlironi»,  
ja dhe paret për nevojat ku do t'shkonin,  
ja dhe radio që sukseset t'na njohtonin!

N'det e n'ajër edhe n'tok', nëpër errsina,  
u vërsulën diversantët me duzinat:  
Hamil Matian e federali Lleshanaku,  
Zenel Shehu, Ndue Pjetri e Et-hem Caku;  
eksi llomi shum Zenela e shum Hamita,

që u gazmuen e zun' bes' se u erdhi dita...  
der ke qeni, Panajoti, që kufinit  
qark na i binte me njisite t'provokimit,  
që i lidhun me at Temen n'radh' t'ushtrisë,  
kish shtri thonjët me ja shkul' zemren Shqipnisë  
për ta ndamun sikur petat e byrekut,  
n'mes t'Itales, Jugosllavit edhe Grekut!

Kjo llomhane, që erdh me afshe krokodilit,  
ktu u shkrinë mu si vesa para diellit!

Këtu u shkrinë edhe i tretëm si qiriu  
se gra e burra ruejn cdo shteg me pushk' për syu!

Mos të rrehen ujqt' e serbit e t'prendimit:

kurr s'ja hqedhin armës ton' të Sigurimit,

as në fushën ball' pér ball' të trimënisë,

as në rrugën e mashtrimit e t'dredhisë!

Se puntori i sigurimit ka cilsin:

t'mshet'n e zemrës menjiher' me ta përpi,

e ka synin prush të kuq si thengjill zjarrit,

kurr nuk tutet as nuk dridhet para varrit;

e ka zemrën pér tamam porsi t'luanit,

hovi i tij, si me qen' hovi i tufanit.

asht gjakftohët kur shkulmon vala e kazanit,

e ka gjumin shum ma t'leht' se e ka skifteri,

s'e ndal kambën as prej breshni, as prej terri,

udhton n'vapë përmidis të përvëlimit,

pér nën akull notoni n'mes të Erbeimit,

e don popullin sikur don i biri t'jatin,

kurrnjihera s'e ka marr' t'njomin pér t'thatin!

Ktë Partia vetë e lindi dhe e rriti,

e edukoi dhe n'përpjekje e kaliti!

Sigurimi, po, asht arma e lavdisë!

Njizet 'vjet gryk' pér gryk' me qen t'Shqipnisë!

N'male e n'fush' me shpin' për tokë i ka mbështetë,  
dora dorës sa me thik' me bajonetë;  
parashutat ua ka lanun var' për krahut  
tue i luejtë era me kok' posht' në dega t'ahut!  
Kush ra n'tokë ndëgjoi zanin: «Je i rrëthuem!  
Luejte kambën, trut' n'hava t'kan fluturuem!  
Mos lëviz, të ftoha brinjt n'automatik,  
miq si ju ketu i pret litari n'grykë,  
u ka rrejt' shefi që u stërviti në Munik!  
Merre radion, jep sinjalin e dështimit,  
kallzoi shefit dat'n e orën e varrimit  
dhe i thuej se s'ka mbetë asgja sekret,  
po ta mbajti, hajde ktu, provoje vetë!»

Gjith trathtarët i lan' kockat n'malet tonë,  
siç ka thanun prisi i dashtun Enver Hoxha!  
Dhe dollarët me dinarë edhe sterlinë,  
ua prem' kmisha, kok' për kokë ua blem' qefina!

Drit' fitoresh shpérndan Ylli i Sigurimit,  
ylli i Palit, Hajdar Tafës dhe i Asimit,  
tre puntorë operativ' të mbasçlirimt,  
qinda tjerve që u kndon poplli kang'n e trimit!  
Kta heronj të armës son' me krahë divash  
e ban' murin e kalas' me rrashta bishash!

Ty po t'tham' or kau me brina i Jugosllavisë;  
e ti thueja miqve t'tu e t'zotve t'shpisë;  
mur me rrashta do t'ju bajm' n'kuifi t'Shqipnisë!  
Do u mbesë koka mbrenda telit, varë në gardh,  
s'mund na prekin asnji fije në livadh!

T'porosisim mos e prek grenzën me krande  
se do t'gjesh ti veç të zez'n e kokës tandë!  
Hiqni mendje nga komploti dhe hafia,  
sot ka armë shum të forta n'dorë Shqipnia!

Ka të fortë, e t'papërkulun Sigurimin, që anmiqve mbrenda e jashtë u kall trishtimin, se gjith poplli sigurim asht, mbar' Shqipnia, N'çdo betejë prijn' Enveri dhe Partia!

## DIBRËS S'IME

Me rastin e 20-vjetorit të  
çlirimit të Peshkopisë

Sa m'kandet, o Dibër, kjo ditë  
t'ja nisi për ty më këndue  
e forca e zanit n'thellsitë  
e grykve t'shkoj' tue ushtue!

Kjo kanga e ime t'bashkohet  
me thirrje t'malsorve ndër maja,  
kur rendën mbas Gjergjit në Sinë,  
tue zbritun nga shkrepa e pllaja;  
kur armët dibrane u ngjeshën  
përpjetë kah malet e Rusë  
e prisin e madh t'Kastriotve  
e ngulën n'kështjellën e Kruisë!  
Të lumshin ty krahët, moj Dibër;  
se t'madhe e ke pasun vikamën;  
qysh ditën që t'prini Moisiu  
anmiqve u vune rrropamën!  
Gjith malet e fushat e tua,  
tue nisun prej Reçit e Dardhës.  
ja shquerën Sultanit krahnorin  
në fushat përmes Valikardhës!  
Sa mote, sa shekuj të randë  
mbi supet e tua kaluen!  
Burrneshë e malsore qëndrove,

kurr shpinën për toke s'ta vunë!  
Me tymin e pish's u tymove  
dhe fjetun me shpinën për gurit,  
në gji ti të ngjeshun për mishit,  
ja ruejte yrnekun flamurit!  
Ky flamur i thirri t'nand' malet  
mb' taborre me u lshue t'Hajredinit:  
«Gajretni me pushkët e gjata  
n'llogore t'Mustafa Jakimit!  
N>tagana ju krenat ua hiqni  
le t'mbyten si kungujt për Drinit!»

Me ditë edhe netë, të tana  
Gjorica u ba tym e flakë:  
nizamye me tufa t'Stambolli  
iu mbeti po qafa në lak,  
dhe uiët e Drinit, të Zi  
mbar' detin e skuqi, me gjak!

Kur zjarri dhe flaka e Stambollit  
u fik në Nandor t'dymbedhjetës,  
të ndezi Serbia nji tjetër  
ma t'kobshëm edhe ma rëngjethës!  
Të mbetën mes tymit e flakëve  
ty, Dibër, po grueja e culla,  
Se koha s'i priti me dalë  
dhe mbrenda t'u dogjën ndër külla!  
Por trime e paepun, shkambore,  
ti zjarrit me zjarr iu përgjegje  
e kockat e lukturat serbiane  
në gropat e tua i dergje!  
Po! Varrin ktu gjeti Serbia!  
Por... dasmën e bani Paria  
se poplli coptou e lüfto  
e krenët për vehte fito!

N'agimin e tetë nandorit  
t'përqafi dhe ty e vërteta!  
Kur doli kushtrimi i Partisë  
dhe ti nise luftën me çeta!  
Mëngjesi në Grykë të Vogël  
at' ditë pranvere buzqeshi:  
në luft' pér çirimin e vendit  
gjith populli armët i ngjeshi!  
Ja pushkët e para kërsitën  
n'Bulqizë dhe n'Kep t'Sofraçanit  
e plumbi hakmarr's i Nazmiut  
në tru u fut thell' t'italianit!  
At-hera gjëmoi Gryka e Madhe,  
Okshtuni e krejt Martaneshi:  
dibranët në kambë jan' ngritun,  
ndër male tue pri Haxhi Lleshi!  
U shprazën e topa e mortaja,  
gjith anësh u msye Peshkopia:  
«Përpara, o shok' partizanë,  
rrethoni dhe biniu n'frangia!  
T'na njohë Italja e gjermani  
dhe gjallë t'mos dalë paria!»  
Rrépt' sulmi vazhdoi pa ndërprenje  
n'Hinoskë dhe mbrrini në Sheher,  
ku sharsat ndër mure ulruen  
tue vjellun po hekur e zeher!  
U dridh anemban' Dibra e Madhe  
se krisi n'çdo derë e dritare,  
legionet e murme u shuen  
gjith anësh tue ramun patare!  
Ja fronti përpara po ecën  
dhe lufta n'mbar' Dibrën u shtri:  
formohet në male t'Sllatinës  
e para Brigad' në veri!  
Brigada e tetmbdhjetë sulmuese,

që msyni kah Luma e Hasi,  
nazistë e fundrrinat e Ballit  
në akull të Drinit i rrasi!  
Pobregu e Bardhocë bublluen,  
bregore e lugina me radhë  
dhe lisat e dushkut u grinë  
në brigjet e Drinit të Bardhë,  
e copat e fundit t'zinxhirit  
të tanksit u ban' grima grima,  
helmetat me kryqin e thyem  
u varën përmbi autoblinda!

Në Gushtin e dyzetekatrës  
mbar' Dibra lirinë e fitoi,  
flamuri i lyem me gjak  
në majë t'Korabit valoi!  
Valvitjet e tija treguen  
Partinë që ndriti pishtar:  
anmiqt' e vllavrasit i rr xuem  
parinë edhe çdo bajraktar!

Kang' t'reja, t'mallgjyeshme u thure,  
nan' Dibër, ti trimave t'tu,  
që n'emën t'atdheut e t'partisë  
mbi gryka t'bukerve jan' true!

I thure Nazmiut edhe Gjokës  
ti vargje të afshit burrnor;  
Demirit, Rizait e Stefanit  
që vdiqën me armë në dorë!  
Dhe Ibja dibrania e re  
ndër breza do t'ketë lavdi:

për diellin e jetës njerzore.  
në hekur t'fashizmit u gri!

— \* —

Ne andrat e Gjok's e t'Nazmiut  
në vend i kem çue dhe do i çojmë:  
me pushkën dhe kazmën në dorë  
sot ne socializmin ndërtojmë!

Me kazmën po djersën e derdhëm,  
nga rranjët ne Dibrën ndryshuem:  
ndër kambët e malit t'Korabit  
qytetin e ri e ndërtuem!

Me pushkën i ruejmë fitoret,  
n'kto brigje ne syni s'na tutet:  
gardh zjarri është kemi kufinin,  
as miza përbrenda s'na futet!

Dibranët i thanë Enverit:  
«Partisë ne besën i dhamë!  
Ne t'mirën e t'keqen mbas teje  
do t'jetë malsori dibran!»

## **FALE JU QOFSHIM NË SHEKUJ TË JETËS!**

**Me rastin e 50-vjetorit  
të Pamvarësisë.**

Falë ju qofshim, o dragojt' e tok's arbnore,  
falë ju qofshim, që s'na latë me dalun dore,  
falë ju qofshim, o ju shpata të çelnikut;  
që kufinin vutë der n'kodra t'Kaçanikut,  
falë ju qofshim ju, o krah't e t'parve tonë,  
Falë ju qofshim n'shekuj t'jetës përgjithmonë!

N'maje t'kepit, ndër stuhi, ju lindi zana,  
ngjesh' në hekur, gjith në shpata e jataganë,  
gjurma gjurmës mbushët vendin me murana  
trimënie, si ai Gjergj Elez Alia,  
që fushë luejti e luejti male nga trondia  
kah i solli me topuz balozit t'detit  
tue ca tokën rrisk' si lkundjet e tërmetit!

Falë të qofshim ty, o vrulli i Kastriotit:  
mb' kala t'Krujës si pishtar i shndrite motit:  
Vrulli i krahut, i shpatës tandem, Kastriot,  
plakës turke ujë ja bani sytë me lot!  
Shum taborre ja përvlove e i dogje n'valë,  
ndër hendeqe krejt u mbetën kuajt me shalë!  
Bir Shqiponje, i dhe krizëm mbret sultanit,  
i kallzovë se si zot i del vatanit!  
Krizma jote n'katër shekuj mbet jehonë,  
primi çefat e lirisë t'mbarë kombit tonë,

që edhe n'kohët ma të vshtira nuk u prulën,  
kurrnjihera jataganin nuk e ulën!

Katërqind e pesdhjetë vite pa pushue,  
gra e burra kundër tarkut kanë luftue.

Kanë luftue porsi asganat me burrni,  
në zidan keq tue heqë si korbi i zi,  
fukaraja tue mos pasun ujë ndër sy,  
tue pasë mbrenda kush tre dhen e kush tri dhi,  
Padishahu lyp xhelep e lyp vergi,

lyp ashar — e për nji kokë bahej kiameti! —  
në malsi ku s'qiste toka as bukë për veti:

e n'kta shkrepë lyp me ngranë Sulltan Gazepi!

S'menë tue lypun ditë për ditë gazepi i zi,  
në të repnën, në të zvëshnën Arbëni,  
ku dhjetë katunde sbashku bluejshin n'nji mulli,  
dymbdhjetë shpi për herrë kishin nji kal' t'zi,  
dymbdhjetë nuse me rend ndrrojshin nji shami,  
dymbdhjetë burra kishin n'front nji kapakli,  
bukën n'torbë, n'istikam krypën përmby,  
hutën n'dorë, rrÿpin ngjesh', qefinin n'gji!

Kshtu kanë hequn dhe kanë vuejtë shqiptar' e  
shkretë  
për m'e ruejtun dhe me e mbajtë emnin e vet!  
Kshtu kanë vuejtun mos me u humbë guri i kufinit,  
mos me humbun gjuha jonë, gjuha e Naimit,  
mos me humbun bes'n e pushk'n e bujarinë,  
as zakonin, as kostumin, as burrninë!

T'mbramat plane kur kulshedra e Stambollit.  
hartoj kobshëm me ja shuemun emnin trollit,  
e ja nisi shqipen n'gozhda me e gozhdue,  
nji me tokën kullat tonë tue i rrafshue,  
**fmitë e djepit, deri ata, tue na i shkrumbue**,  
maje n'maje shunglloj toka si prej motit,  
britm' e madhe duel prej vorrit t'Kastriotit.

«N'kambë, shqiptarë! Rrokni spatat në, kto dhëna,  
pritnia kokën türkut, gjarpnit me dy krena,  
asnji n'kambë në kto vise gjallë t'mos mbesi,  
ksula e bardhë të bahet zot e t'zhdaket fesi!  
Ngreni Shqipen të valvit' nepër ajri,  
t'i prij kombit veç flamuri kuqezi!»

Zani i fortë i të madhit Skënderbeut,  
çoi shqiptarët t'gjith në kambë si miza dheut!  
Ngriten krye t'gjitha fushat mbarë t'Kosovës,  
Dibra e Luma me malasinat e Gjakovës,  
ç'mban Mirdita, n'Malsi t'Madhe e n'Shalë e n'Shosh,  
Mati e Lezha e mbrrini krizma n'Tarabosh,  
Durr's, Tirana e nahia e Elbasanit,  
Muzeqeja deri n'malin e Sazanit,  
Vlona mbarë me Himarë e Mallakastër.

Kurveleshi, Konispol e Gjinokastër,  
u çue Përmeti me Kolonjë e me Skrapar,  
Korça krisi bashkë me Gorë e me Opar:  
fort shterngue rrokën armët për kondakut,  
laku i kambës zu t'i dridhet turkoşifikat:  
si kasapi kur var mish kortar-kortar,  
kshtu i varën zabitllarë e pashallarë!

Gjith Kosovës, Toskve e Gegve për liri,  
për rilindje t'kombit tonë i kanë pri,  
Abdyl Frashër, Mihal Grameno e Çerçiz Topulli,  
le e rritë e pre për masë si prisa populli;  
Hasan Prishtinë, Gurakuq e Bajram Curri,  
Nkoll Kaçorr, Hoxh Tasim e Ded Gjoluli,  
Bajo Topulli e trimi i rrallë Rrapo Hekali,  
Plaku i Vlonës, prisi i parë, Smail Qemali.

Bash si driten Lirinë kombit ja kanë dashtë,  
pushka e penda s'i ndal kurr as mbrendë as jashtë!

Për të hequń qafet zgjedhën e otomanit,  
kurrnjihera nuk iu tut syni nishanit,  
dersa shtypjen shekullore e varrosën  
edhe turkut rranc' n e rrancës ja çfarosën!

Në Nandor, në nandqind e dymbëdhjetë,  
n'mëmedhe fluturoi shqipeja me fletë!  
U hap lajmi, porsi lajmi i Maratonës:  
«Ngriti flamur Ismail Qemali i Vlonës!»  
Dhe ky lajm e përshkoi botën breg e n'breg  
se shqiptarët janë të gjallë e nuk kanë vdekë!  
Mbas robnisë ma se katërqindvjeçare,  
Shkaba e zezë me fushë t'kuqe u ngrit krenare!

\* \* \*

N'hie tuej qofshim né, kreshnik't e motit,  
që ja mbajtët amanetin Kastrioti!  
Brez mbas brezi n'mend do t'mbetet vjeshta e tretë,  
pamvarsia që u fitue n'njizet e tetë!  
Zemrat tonë do t' t'kufojnë djalë mëas djali,  
ty, o Vlonë, ku ka le Smail Qemali,  
ty, o Vlonë, o prush i kuq i Labërisë,  
q'je shkëlqimi i faqes sonë të historisë!

\* \* \*

Sot ktë flamur, që dikur e ngriti Vlona,  
e ka kapun dora e fortë njizetenanda!  
Njiztenanda në nandor dyztekatër,  
ngriti rishtas ktë flamur né quell të kaltër,  
dhe e nguli me beton né troje t'veta,  
e s'do t'shkulet kurrnjiher' sa t'jetëjeta!

Njikjo dorë asht Partia me gjith Prisë,  
që n't'gjith botën ja çoi zanin Shqiptarisë  
dhe e bani nji kala që kurr s'dorëzohet,  
murit t'saj sot askërkush s'mund t'i afrohet!  
N'ktë kala shkëlqen dielli i socializmit  
dhe idetë largëpamse t'Leninizmit!

20. ATAMBA

\* \* \*

O stërgjysha! Cohi n'kambë e na bekoni,  
çohi e shifni Shqipninë edhe na thoni,  
çohi e shifni dhe t'krenohi prej gëzimit  
tue pa hasmët që tërbohen prej dëshprimit!

Skënderbe, çohu e shif ktë mrekulli,  
n'vendin tand na ka le Skënderi i ri:

Enver Hoxha sypamtrembun,  
që i pret shpata n'katër anë,  
ban kuvend me njiqind krala,  
si bilbili kndon n'Tiranë!

## ARMATA E RE

Me rastin e 20-vjetorit të  
Ushtrisë Popullore

Ndër krahë i shkofshim — Armatës së Re,  
që e bani egërsinën — t'i vijë era dhë!  
Sa sot s'guxon kushi — me luejt' ma me ne!

Në kohët e shkuemë — po, sene për sene:  
me fesa, me shapka — qen' mbushun kto vende.  
Ne tamblin e nanës — na e nxuer otomanë  
e pushkën ke bërinjët — na e vù grekomani,  
e brigjet e kaltra — nà i thithi italiani;  
të egër, t'pangopuni — përher serboindhejt  
në shpinë i kem pasun — gjithmon' si çakejt'

Pa zot qe Shqipnia — dhe n'koh' të Zogollit,  
që djersën e popullit — ja jepte oborrit.  
Barkunti, kambzbathuni — coptoju, puno:  
satrapi n'pallate — përqaj e sundo!

Kur fesat e Duçes — u sulën n'kto ana  
satrapi ja mbathi — me hik' nga Tirana  
me ar e argjendin — tue mbushun maqinën,  
xhandarët gjithanësh — tue ruejt' Geraldinën!

Po djemt' e Shqipnisë — si Mujo Ulqinaku,  
i priten me plumba — s'duruen jo ke praku,

s'duruen jo sunduesë — Viktora dhe Duçe!  
Këmishat e zeza — ua banë të kuqe!

Mëngjesi i pranverës — agoi për ne, shokë,  
Partia Komuniste — kur lindi n'ktë tokë!  
Shqiponjës së strukun — që dergjesh pa krah  
e zemër e fletë — Partia i dha!  
At-hera mbi male — Shqiponja flutroi,  
kur pushka e Partisë — mbi pllaja gjëmoi!

N'themëlet e fundit — u trand tirania  
se çetat e malit — u rritën me mijë!  
Në front të clirimit — qe populli mbarë;  
shegerti, argati, — puntorë e fshatarë;  
nën shembull t'Qemalit, — të Vojos, t'Përlatit,  
këthethrat gjaksore — ja kputën xhelatit!  
Në kohët ma t'egra — të valës s'terorit,  
e ban' kryqin copa — dhe spat'n e liktorit!

Ndër gryka e qytete — kudo krisi pushka!  
Çelnikun e tanksit — e shtypëm me grushta,  
çdo kullë e kasolle — u banë istikame,  
prej flakës së kuqe — t'fuqis' partizane!  
Më dyzetetreshin — më dhjet' të korrikut,  
Enveri me shokë — nën mjekër t'anmikut,  
mu ditën për diell — në mes t'Labinotit,  
në gryka t'mortajës — dhe t'gjyleve t'topit,  
përhapën si rrfeja — ndër male t'Shqipnisë  
lajmrimin t'formimit — të Shtabit t'Ushtrisë!  
Sa shpejt, batalionet — u banë brigada,  
kshtu nisi marshimi — ndër rrugë të gjata:  
Përleshjet e dimnit — dhe t'valës s'qershori,  
i ndriti fitorja — në ditë t'nandorit!

Vullneti i pashoq — i ushtris' së clirimit,  
e ndoqi egersinën — matanë t'kufinit:  
kaloi Prizerentin — e shkoi n'Mitrovicë,  
përtej Vishegradin — nalt, përmbi Sienicë,  
dersa e përplasi — në porta t'Berlinit  
Ushtria e Kuqe — Ushtria e Stalinit!

Mbi tokën arbnore — n'kto troje, n'ktë dhé  
e mori fuqinë — Armata e Re!  
Armata e Enverit — fitoret i mbroi,  
n'dredhina e n'përpjekje — n'rreziqe kaloi  
e gjakun e derdhun — me gjak e mbuloi,  
por armën prej dore — askurr nuk e lshoi!  
Këthetrave t'Titos — u doli matanë:  
i mbetën divizjet — me krande ndër dhambë!  
N'kuhi provokimet — e greku dështuen:  
helmetat engleze — ke vorret ua vumë!  
Në kodra t'Bilishtit — e drejt Follorinës  
i dogjëm si pleshtat — në flak' të benzinës!

Xhelatve t'Daj Samit — ne thonjt' ua zbuluem  
dhe flotën e gjashtë — n'Mesdhé ja gozhduem  
me grupin e Temes — n'xhenem ua dërguem!

Sot zani na ndihet — si pushka e Hotit,  
se jemi si Osja — në kull' të barotit,  
se e tan' Shqipënia — sot asht nji ushtri  
me gra e me burra — me pleq e me fmi!  
As dreqit e t'birit — s'i trembemi kuj  
se kemi nji flotë — mbi ujë e nën ujë!  
Me shtatë pal' brina — le t'jetë kryqzori,  
i çahet kazani — i plaset motori!

Pa mbrojtje përherra — kan' qen' kto hapsina.  
Flutrojshin bumballat — çdo dit' me ulrima!

Shqiptarët e shkretë — t'pashkollë e n'vorfni.  
i shifshin nga toka — përpjet' me habi!  
Sot djali i të vorfnit — asht bamun shkollar,  
pilot ai asht bamun — i klasit të parë,  
mbi krah' të shigjetës — fluturon si vetima,  
lart n'ajrin e pastër — përdridhet turbina!  
Kur ke nji ushtri — t'vertet' popullore,  
kur ke oficera — të regjun n'llogore,  
kur asht po bashkimi — i popullit mbarë,  
kur asht me nji fjalë «nji» kombi shqiptar;  
kur ke nji Parti, sic asht kjo e jona,  
Komandanti yn' — kur prinë, Enver Hoxha:  
le t'zij e qetë puna — n'katund e fabrikë,  
se je e garantueme — për jetë, Republikë!

(Emri) (K) (D) (L) e tësia

..... labasitët idhurëq minus 5%

..... vjetorëmëq sëmundje e emraveve e tësia

..... emra sëmundje

..... sëmundje si tregtësi ëm mësimdhënës si tësia

..... si e sëmundje

**BIBLIOTEKA E SHTETIT**  
**GJERGJAS FERD**

**PASQYRA E LËNDËS**

Parathënie (K. Jakova)	3
Valët e Drinit të Zi (poemë)	7
Në sulm përmbi barikada!	47
Shpatë e xhveshme e klasës punëtore	55
Dibrës sime	62
Falë ju qofshim më shekuj të jetës	67
Armatat e re	72